



# **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në Prokurorinë e Përgjithshme

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“AUDITIM FINANCIAR MBI VEPRIMTARINË E  
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME”**

**Prill 2024**

## **PËRMBLEDHJE**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.....	3
I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.....	5
II. Hyrja.....	7
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	7
2. Identifikimi i çështjes:.....	8
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën uditim:.....	8
4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:.....	8
5. Kriteret e vlerësimit:.....	8
6. Standardet e Auditimit:.....	9
7. Metodatat e auditimit:.....	9
8. Dokumentimi i auditimit:.....	10
III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT .....	10
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:.....	11
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit. ....	11
2.2 Auditimi i llogarive vjetore.....	16
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. ....	39
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....	47
VI. ANEKSE.....	53

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Prokurorinë e Përgjithshme, më poshtë e emërtuar “PP”, për periudhën nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2023, me objekt “Mbi auditimin financiar”.

Auditimi kishte në fokus tre drejtime kryesore, sipas programit të miratuar me nr. 1030/1 prot., datë 15.12.2023, dhe në të u angazhuan 3 (tre) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u përqendrua kryesisht në aktivitetin e PP mbi planifikimin dhe realizimin e planit buxhetor, auditimin e pasqyrave financiare, zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e vlerave monetare e materiale, dhe çështje të dala gjatë auditimit.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë zhvillimit të këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e Procedurave të Auditimit, Kodi i Etikës, si dhe praktikata më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të PP për periudhën nga data nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2023, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar Auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

## I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
A/5	<p>Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit dhe regjistrit për vitin 2022 u konstatua se,</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 2187 “Të tjera pajisje zyre” dhe jo në llogarinë 218600 “pajisjeve elektronike”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.</li><li>- Një pjesë e “Pajisjeve dhe instalimi i kondicionerëve” janë klasifikuar në llogarinë 218700 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, por pa ndikim në vlerën neto të aktiveve pasi normat e amortizimit është 20% për të dy klasifikimet.</li><li>- Nga auditimi u konstatua se institucioni pas procesit të vlerësimit ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivitetet e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën prej 9,137,662.9 lekë, ku në pasqyrat financiare të mbyllura për vitin 2022, këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune.</li><li>- Në procesverbalin me nr. 987/1, datë</li></ul>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 16-40, të Raportit të Auditimit</i></p>	E mesme	<ul style="list-style-type: none"><li>- Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.</li><li>- Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre.</li></ul>

	<p>15.07.2022 të mbajtur nga komisioni “Për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi ” është propozuar kthimi i katër artikujve në magazinë në vlerën 246,282 lekë, ku nga institucioni nuk është bërë Fletë hyrje dhe as asgjësim i tyre, si dhe as kalimi në llogarinë 24 “Aktive të Qend.te trupëzuara te dëmtuara”.</p> <p>- Për tre artikuj në vlerë totale 314,617,41 lekë, që komisioni ka vendosur të mos asgjësohen, por ti kalojnë për skrap Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, kjo vlerë është hequr nga kontabiliteti dhe nuk është reflektuar në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” në llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën neto deri në momentin e transferimit.</p>			
A/7	<p>Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit rezultoi se, në rubrikën D “Fondet e konsoliduara nga Institucioni” është pasqyruar llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” në vlerën 5,633,890 lekë. Nga analiza e zërave në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto llogaria 106 është pasqyruar në vlerën 0 lekë. Nga auditimi i hyrjeve të aktiveve pa pagesë rezultoi se vlera e paraqitur në llogarinë 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” ka të bëjë me kalimin në pronësi të aktiveve pa pagesë transferuar nga E. V, për të cilat janë njohur në momentin fillestar në llogarinë 21, të aktiveve afatgjata dhe është bërë hyrje në institucion me datën 05.01.2022. Pasqyrimi i llogarisë 106 “Teprica e Granteve kapitale te Huaja” në vlerën 5,633,890 lekë në rubrikën D, është veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshur, paragrafi 1.1.2.</p>	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 16-40, të Raportit të Auditimit</i>	E mesme	- Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa për sistemimin e llogarive në kontabilitet, duke debituar llogarinë 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” në vlerën 5,633,890 lekë dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa të fondit bazë” me po të njëjtën vlerë.
A/8	<p>Nga auditimi i pasqyrës së “cash flow” u konstatua se, nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2022 janë bërë shpenzime kapitale në shumën prej 104,904,075 lekë. Në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” janë pasqyruar rritje nga blerjet e krijuara gjatë vitit 2022 në shumën prej 36,740,524 lekë, me një vlerë më pak prej 68,163,551 lekë, ku në shënimet shpjeguese është cituar se kjo vlerë është kaluar tek Prokuroria Rrethit Kukës, duke mos dokumentuar asnjë “Gjurmë auditimi” të kalimit të këtij transaksioni. Shuma e investimit për “Rikonstrukcionin e godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës” është planifikuar dhe realizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për rrjedhim: Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, paragrafi 2.1.</p>	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 16-40, të Raportit të Auditimit</i>	E mesme	- Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa në vijimësi, që për investimet të cilat janë planifikuar dhe realizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, para se të vihen në shfrytëzim dhe para se të bëhet miratimi i kalimit pa pagesë të vlerës së aktivitet, detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen në llogarinë 23 “Investime”, me qëllim dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi.
A/9	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se:</p> <p>- Nga auditimi i pasqyrës së “Pozicionit financiar të konsoliduar” është bërë debitimi i llogarisë 468 “Debitorë të</p>	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 16-40, të Raportit të Auditimit</i>	E mesme	- Drejtoria Ekonomike dhe Financës, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa në vijimësi, që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me

<p>ndryshëm” në vlerën 1,724,750 lekë, vlerë e cila është kredituar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm”. Nga analiza e shpenzimeve buxhetore të vitit 2022 rezulton se, kjo shumë është detyrim ndaj palëve të treta për blerje mallra/shërbime/punë dhe jo të drejta të lindura ndaj institucioni, vlerë e cila duhet të ishte debituar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.</p> <p>- Nga auditimin i të dhënave të pasqyrës 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” për pakësimet e aktiveve në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, nga njësitë nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.</p> <p>- Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës “Cash Flow” dhe pasqyrimi i ndryshimit të llogarive në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi mosrakordim të shumave të arkëtuara për llogarinë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” dhe llogarinë 532 “Vlera të tjera”, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrës së “Pozicionit financiar”, por pa ndikim material. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, paragrafi 1.1 pika 2.1.</p>			<p>metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare të konsoliduara. Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korrigjimin e sistemit të tyre në pasqyrat financiare të viteve pasardhëse.</p>
--	--	--	--

### I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Në përfundim të auditimit financiar të ushtruar në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 31.12.2023, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 1030/1 prot., datë 15.12.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin, si më poshtë:

Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator në fuqi: Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj., duke mbështetur dhënien e një opinioni të pakualifikuar.

#### ***I. Opinion mbi pasqyrat financiare (i pakualifikuar<sup>1</sup>)***

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Prokurorisë së Përgjithshme, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

<sup>1</sup> Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e Manualit të Auditimit Financiar” të Kryetarit të KLSH-së (fq 54) kapitulli VII pika 7.4.1 “Opinioni të pakualifikuar” të auditimit paragrafi opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

### **Opinionioni:**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator në fuqi: Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

Nga auditimi financiar, mbështetur në, ISSAI 200 “Parimet e auditimit financiar” dhe ISSAI 2000 “Aplikimi i Standardeve të Auditimit Financiar”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së, nën gjykimin tonë, kontabiliteti dhe pasqyrat financiare të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme, në përgjithësi, në të gjitha aspektet materiale, janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Megjithatë, nga auditimi financiar rezultuan edhe anomali e parregullsi apo raste të shkeljeve të dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, të konsideruara *jo materiale dhe jo të përhapura*, në llogaritë vjetore individuale e të konsoliduara në nivel grupi apo në transaksionet në fjalë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një **“Opinionii të pakualifikuar”** të auditimit *“Theksim Çështjeje”*.

### **Baza për opinionin:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime jo materiale por jo të përhapura, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 44,550 mijë lekë si dhe anomali të konstatuara, për këto arsye kemi dhënë Opinionin të Pakualifikuar të auditimit me *“Theksim Çështjeje”*, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm: Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionin Prokurorisë së Përgjithshme dhe subjektet e varësisë së saj, sipas kërkesave të legjislacionit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuar si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i zërave të kontabilizuar në llogarinë 4342 *“Operacione me shtetin (të drejta)”* është regjistruar dhe vlera e llogarisë 401 *“Furnitorë e llogari të lidhura me to”* në shumën prej 467,436 lekë, vlerë e trashëguar që përpara vitit 2010, duke humbur statusin e detyrimeve afatshkurtra, sipas përcaktimit të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018, i ndryshuar, paragrafi 3.2 *“Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”*.

- Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një subjekt në tjetrin në disa praktika u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur miratimin për kalim kapitali, autorizimi i tërheqjes së aktivitetit, procesverbali i marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga institucioni që ka bërë kalim kapitali, deri në momentin e daljes nga pronësia, ku vlera e këtyre aktiveve të transferuara janë regjistruar me vlerën historike nga institucionet përfituese, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës reale të aktiveve neto.

- Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit dhe regjistrimit për vitin 2022 u konstatua se, një pjesë aktiveve *“pajisjeve elektronike”* janë keqklasifikuar në llogaritë kontabël, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve

neto të institucionit.

- Nga auditimi u konstatua se institucioni pas procesit të vlerësimit ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivet e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën prej 9,137,662.9 lekë, ku nga PP këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune dhe nuk janë kontabilizuar në llogarinë 24 “Aktive të Qend.te trupëzuara te dëmtuara” deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre, duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një Fletë hyrje rikupero.

- Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite vlera e tyre është papërfillshme ose 0. Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune. Nga institucioni nuk janë marrë masa për të ngritur grupe e pune me ekspertë të fushave, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre.

- Nga auditimin i të dhënave të pasqyrës 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” në pasqyrat financiare të konsoliduara rezultoi se për pakësimet e aktiveve në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, nga njësitë nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar rezultoi se është bërë debitimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 1,724,750 lekë , vlerë e cila është kredituar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm”. Nga analiza e shpenzimeve buxhetore të vitit 2022 rezulton se kjo shumë është detyrim ndaj palëve të treta për blerje mallra/shërbime/punë, vlerë e cila duhet të ishte debituar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

### **Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit**

Strukturat menaxheriale të Prokurorisë së Përgjithshme janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësia e audituesve të KLSH për auditimin financiar.**

Përgjegjësia e audituesit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare, bazuar mbi rezultatet e auditimit. Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë.

## **II. Hyrja.**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 1030/1, datë 15.12.2023, në Prokurorinë e Përgjithshme, nga data 15.12.2023 deri më datën 29.01.2024, për periudhën e auditimit 01.01.2022-31.12.2023, u krye auditim financiar, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J. G, (përgjegjës grupi)
2. M. N, anëtar
3. E. M, anëtar

### **1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

**Objektivat specifike të auditimit** - Auditimi financiar synon dhënien e një vlerësimi të pavarur, që rezulton në një konkluzion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një

subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejte dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar. Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare do të jene:

-Hartimi i pasqyrave financiare nga Prokuroria e Përgjithshme për aparatit dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar, etj.

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën në auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-saktësia dhe plotësia e informacionit kontabël mbi raportimin financiar dhe hartimi i pasqyrave të konsoliduara për sistemin e qeverisjes së përgjithshme.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

**Qëllimi i auditimit** është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

## **2. Identifikimi i çështjes:**

Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 1030/1, datë 15.12.2023.

## **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Niveli menaxherial i Prokurorisë së Përgjithshme është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

## **4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Audituesit e KLSH-së kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi çështjet që janë nën auditim.

## **5. Kriteret e vlerësimit:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e



*Kontrollit të Lartë të Shtetit*”;

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “*Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*”; i ndryshuar me Udhëzimin MF nr. 5, datë 21.02.2022.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”;
- Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*”;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Rregullore e brendshme “*Mbi Procedurat e auditimit në KLSH*”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024.

## **6. Standardet e Auditimit:**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Kërkesat e "Udhërrëfyesit të IDI, INTOSAI" *Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit*”;
- Standardet Kombëtare të kontabilitetit.
- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022;

## **7. Metodatat e auditimit:**

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet dhe investimet. *Nga përlllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin Prokuroria e Përgjithshme, niveli i materialitetit për vitin 2022 rezultoi në vlerën 44,550 mijë lekë.*

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri në të moderuar.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me

originë nga një burim tjetër.

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse.

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specififikisht drejtimeve të auditimit.

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit.

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të MTM, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat, etj.

### **8. Dokumentimi i auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.

## **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

1. Prokuroria e përgjithshme ka juridiksionin mbi të gjithë territorin e republikës së Shqipërisë.

2. Prokuroria e përgjithshme përfaqëson përpara Gjykatës së lartë dhe Gjykatës Kushtetuese çështjet kompetente lëndore të juridiksionit të përgjithshëm dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

3. Prokuroria e përgjithshme organizon, drejton dhe mbikëqyr:

a) shërbimin financiar në zbatim të detyrave që rrjedhin nga ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin e kontrollit financiar në institucione dhe njësi ekonomike financiare të të gjithë niveleve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

b) shërbimin e sekretarit të prokurorisë në të gjithë nivelet e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, sekretari e cila kryen funksionin administrativ dhe procedurat në zbatim të ligjit;

c) veprimtarinë administrative të saj dhe të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm sipas rregullave të miratuara për procedurat e lëvizjeve paralele dhe ngritjeve në detyrë të nëpunësve

civil në prokurori, me përjashtim të kancelarëve;

ç) veprimtarinë e shërbimit të teknologjisë së informacionit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas rregullave të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave;

d) veprimtarinë e shërbimit për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë juridiksion të përgjithshëm dhe kujdeset për vënien në dijeni publikun dhe mediat për veprimtarinë e kryer duke i kushtuar vëmendje parimeve të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë, të dhënave personale, konfidentalitetit, ruajtjes së sekretit, reputacionit dhe prezumimin e pafajësisë;

dh) veprimtarinë e arkivit në prokurorinë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit për arkivat shtetërore, dhe bashkërendon me Arkivat Shtetërore të Sistemit Gjyqësorë, për ruajtjen përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit të prokurorisë që i nënshtrohet arkivimit;

e) zbatimin e rregullit dhe sigurisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit dhe kriterëve e procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Për realizimin e funksionit të saj, PP funksionon sipas strukturës dhe organikës organizative/faktike të miratuar.

## 2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

### 2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit: Hartimi, zbatimin i buxhetit të shtetit

- Zbatimin i kriterëve në planifikimin e buxhetit, realizimi i planit buxhetor, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

**- Zbatimin i kriterëve në planifikimin e buxhetit, realizimi i planit buxhetor, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.**

Auditimi u krye për periudhën 01.01.2021 deri më 31.09.2023, duke mbajtur parasysh legjisllacionin e mëposhtëm:

- Ligjin me nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
  - Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015;
  - Ligji nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”;
  - Ligji nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”;
  - Ligji nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”;
  - Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të MFE;
  - Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” të MFE;
  - Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” të MFE;
  - Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
  - Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.
- 2022**
- Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 10.01.2022, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022” të MFE;
  - Udhëzimit nr.9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”;

- VKM nr.130, datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023 – 2025”;
- Udhëzimin Plotësues nr. 22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025”;
- VKM nr. 535, datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025”;

### **2023**

- Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të MFE;
- Udhëzimit Plotësues nr. 2/1, datë 06.06.2023, “Për një shtesë në udhëzimin plotësues nr. 2 datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” të MFE;
- Udhëzimit nr.5, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”;
- VKM nr. 195, datë 05.04.2023 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024 – 2026”;
- Udhëzimin Plotësues nr. 22, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026”;
- VKM nr. 436, datë 19.07.2023 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026”;
- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.

### **Viti 2022**

#### *Përgatitja e PBA 2023-2025*

Me daljen e udhëzimit nr. 9 datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, nga MFE, me Urdhrin nr. 14 datë 03.03.2022 të Prokurorisë së Përgjithshme, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik. GMS është ngritur në përputhje me Pikën 8/b, Nenit 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Me emailin e datës 07.03.2022, nga përgjegjësi i sektorit, Drejtoria Ekonomike dhe Financës, është dërguar në të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë (prokurorive) udhëzimi vjetor për përgatitjen e PBA 2023-2025, si dhe formatet e kërkesave buxhetore së bashku me model relacionin shpjegues. Të 30 prokuroritë kanë nisur kërkesat e tyre buxhetore për secilën fazë të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.

#### ***Konstatim:***

GMS është ngritur po nuk janë zhvilluar takime për të miratuar Drejtuesit dhe anetarët e Ekipeve të menaxhimit të programit dhe dokumentin e kërkesave buxhetore afatmesme, për tre vitet 2023-2025, fazën e parë strategjike dhe fazën e dytë teknike duke qënë se nuk janë mbajtur proces verbale.

Me shkresën nr. 332/2, datë, 27.04.2022, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2023-2025, fazën e parë, strategjike.

Me shkresën nr. 332/3, datë, 27.04.2022, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë dokumentin e kërkesave të Projekt Buxhetit 2023-2025.

Me shkresën nr. 1053/29 datë, 31.08.2022, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2023-2025, fazën e dytë, teknike.

Pasqyra e tavanëve të miratuara për Prokurorinë e Përgjithshme (2023-2025)

000 Lekë

Emertimi	Viti buxhetor 2023	Viti buxhetor 2024	Viti buxhetor 2025
Shpenz. Korente	2,240,000	2,243,800	2,243,800

Shpenz. Kapitale	130,000	130,000	130,000
Totali	2,370,000	2,373,800	2,373,800

Me ligjin nr. 115/2021, datë 16.12.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2022, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Prokuroria e Përgjithshme”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2022, janë miratuar në një program buxhetor; 01110 - Planifikim, Menaxhim dhe Administrim, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme.

Fondi i rakorduar për programin buxhetor 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2022 ishte 2,424,270 mijë lekë. Buxheti në total:

- për vitin 2023, në vlerën 2,370,000 mijë lekë është parashikuar me një ulje prej 54,270 mijë lekë në krahasim me vitin 2022;
- për vitin 2024, në vlerën 2,373,800 mijë lekë është parashikuar me një rritje prej 3,800 mijë në krahasim me vitin 2023;
- për vitin 2025, në vlerën 2,373,800 mijë lekë është parashikuar në të njëjtin nivel me vitin 2024.

#### Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2022.

Gjatë vitit 2022, buxheti i grupit buxhetor është rishikuar.

Buxheti i rishikuar vjetor për programin 01110- “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, Prokurorinë e Përgjithshme, pas ndryshimeve është 2,256,017 mijë lekë, ndërsa realizimi vjetor është 2,205,982 mijë lekë ose në masën 97.77 %.

Për vitin 2022, realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit (vetëm programit 01110- “Planifikim, menaxhim dhe administrim”) është 76 mijë lekë.

#### **Raporti i shpenzimeve të programeve, sipas artikujve për vitin 2022**

*Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”*

000/lekë

<i>Programi</i>	<i>Buxheti i fillimit të vitit 2022</i>	<i>Buxheti i rishikuar vjetor 2022</i>	<i>Realizimi për vitin 2022</i>	<i>% e realizimit për vitin 2022</i>
<b>01110</b>	2,424,270	2,256,017	2,205,982	97.77 %

Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik paraqitur në **Aneksin 1.1** ‘Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” bashkangjitur Raportit të Auditimit.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, buxheti i grupit buxhetor është rishikuar, paraqitur në **Aneksin 1.2** “*Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2022*” bashkangjitur Raportit të Auditimit.

Mes përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Në është mbajtur akt rakordimin me datë 30.01.2023, sipas llogarive 600, 601, 602, 605 dhe 606 për periudhën 01.01.2022- 31.12.2022 për planin fillestar në vlerën planin përfundimtar.

#### Investimet

Projekte me financim të brendshëm paraqitur në **Aneksin 1.3** ‘*Projekte me financim të brendshëm për vitin 2022*’ bashkangjitur Raportit të Auditimit.

Shpenzimet kapitale në planin fillestar janë në vlerën 130,000 lekë. Në planin e rishikuar vlera për vitin 2022 arrin në 113,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 108,802,462 lekë ose 96 % e vlerës së planifikuar. Nga të cilat vlerën më të lartë të investimeve e zë investimi projekt+ rikonstruksion i godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës në vlerën 68,163,551 lekë ose 63 % të investimeve në total, Prokuroria e Rrethit Berat zë 2 % në vlerën 2,150,067 lekë për rikonstruksion godine, vendosje të sistemit me kamera si dhe orendi zyre. Prokuroria e Rrethit Elbasan në vlerën

940,320 lekë për rikonstruksion godine dhe pajisje zyre, Prokuroria e Rrethit Vlorë në vlerën 548,000 për blerje orendish zyre, Prokuroria e Rrethit Tiranë në vlerën 210,000 lekë për blerje pajisje zyre si dhe Prokuroria e Rrethit Tropojë në vlerën 50,000 lekë për pajisje zyre. Në planifikimin fillestar nuk kanë qënë të parashikuara projekti dhe rikonstruksioni i godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës, pajisje zyre: për Prokurorinë e Rrethit të Elbasanit, Prokurorinë e Rrethit Tiranë, Prokurorinë e Rrethit Berat dhe vendosja e sistemit të kamerave për Prokurorinë e Rrethit Tiranë dhe Elbasan të cilat janë vlerësuar për tu kryer në planin e rishikuar për vitin 2022. Nga plani i rishikuar nuk është realizuar vetëm për Prokurorinë e Rrethit Tiranë vendosja e sistemit me kamera e planifikuar në vlerën 2,723,603 lekë.

Rikonstruksionet e godinave për vitin 2022 janë realizuar për tre institucione: Prokuroria e Rrethit Elbasan, Kukës dhe Berat. Investime të domosdoshme edhe në kuadër të hartës së re gjyqësore.

Raportet e monitorimit:

Për vitin 2022 Prokuroria e Përgjithshme i ka dërguar 3 raporte monitorimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme së Buxhetit:

- ✓ 4 mujorin e parë të vitit 2022 datë 18.05.2022,
- ✓ 8 mujorin e vitit 2022 datë 20.09.2022 dhe
- ✓ 12 mujorin e vitit 2022 datë 20.02.2023.

## **Viti 2023**

### **Përgatitja e PBA 2024-2026**

Me e-mailin e datës 10.03.2023, nga përgjegjësi i sektorit, Drejtoria Ekonomike dhe Financës, është dërguar në të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë (prokurorive) udhëzimi vjetor për përgatitjen e PBA 2024-2026, si dhe formatet e kërkesave buxhetore së bashku me model relacionin shpjegues, ku 8 prokuroritë që janë bashkuar në kuadër të hartës së re gjyqësore kanë bashkëpunuar me prokuroritë pritëse për të paraqitur kërkesat e tyre. Me datë 17.07.2023 i është nisur sërish email të gjithave njësive shpenzuese të varësisë (prokurorive) për fazën e dytë të PBA-së.

Të 15 prokuroritë (prane Gjykatës së Shkallës së Parë: Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Mat, Përmet, Berat, Krujë, Kavajë, Lezhë, Lushnje, Gjirokastrë dhe Gjykatës së Apelit) kanë nisur kërkesat e tyre buxhetore për secilën fazë të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Me shkresën nr. 386/16, datë, 28.04.2023, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2024-2026, faza e parë, strategjike.

Me shkresën nr. 386/17, datë, 28.04.2023, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë dokumentin e kërkesave të Projekt Buxhetit faza e parë 2024-2026.

Me shkresën nr. 386/17, datë, 28.04.2023, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë dokumentin e kërkesave të Projekt Buxhetit fazën e dytë 2024-2026.

Me shkresën nr. 1160/15 datë, 31.08.2023, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e kërkesave buxhetore, PBA 2023-2025, fazën e dytë, teknike.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mangësi në dokumentimin e plotë të procedurave të hartimit të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025 dhe 2024- 2026.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dokumentacionit të hartimit të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025 dhe 2024- 2026 u konstatua se: - Nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, për miratimin e Drejtuesit dhe anëtareve të Ekipeve të Menaxhimit të Programit dhe dokumentin e kërkesave buxhetore afatmesme. - Në kërkesat e PBA 2024- 2026, në të dy fazat nuk janë paraqitur kërkesat

	e detajuara mbi investimet e planifikuara sipas kërkesave nga prokuroritë por janë përfshirë në Prokurorinë e Përgjithshme si një vlerë totale, vetëm duke përcaktuar emërtimin e projektit. Në vazhdimësi formati i investimeve të planifikuara të paraqitet më i detajuar duke specifikuar emërtimin e projektit për cilën prokurori është planifikuar investimi. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2022 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025”; Udhëzimin nr. 5, datë 28.02.2023 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2024- 2026”, si dhe neni 8 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi nr. 9, datë 28.02.2022 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025”; Udhëzimi nr. 5, datë 28.02.2023 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2024- 2026”; Pika 8/b, Neni 8 të Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e bashkëngjitjes së dokumentacionit mbi hapat e ndjekura mbi Planifikimin Buxhetor Afatmesëm, ngritjes së GMS-s, mbledhjeve të kryera nga institucioni sjell mungesën e transparencës së plotë të vendimeve të marra.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e ndjekjes së plotë të hartimit të PBA, mos shoqërim me proces verbale.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Prokuroria e Përgjithshme të marrë masat në vijimësi, për dokumentimin me proces verbale, mbi takimet konsultative me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në lidhje me kërkesat buxhetore të PBA si dhe mbi mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Planifikimin e investimeve ta paraqesë më të detajuar, duke specifikuar emërtimin e projektit se për cilën prokurori është planifikuar investimi.

*Pasqyra e kërkesave buxhetore dhe tavanëve të miratuara për Prokurorinë e Përgjithshme (2024-2026);*

000 Lekë

Emertimi	Viti buxhetor 2024	Viti buxhetor 2025	Viti buxhetor 2026
Shpenz. Korente	2,413,800	2,413,800	2,403,800
Shpenz. Kapitale	130,000	130,000	130,000
Totali	2,543,800	2,543,800	2,533,800

Fondi i rakorduar për programin buxhetor 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2023 ishte 2,620,500 mijë lekë. Buxheti në total:

- për vitin 2024, në vlerën 2,543,800 mijë lekë është parashikuar me një ulje prej 76,700 mijë lekë në krahasim me vitin 2023;
- për vitin 2025, në vlerën 2,543,800 mijë lekë është parashikuar në të njëjtin nivel me vitin 2024;
- për vitin 2024, në vlerën 2,533,800 mijë lekë është parashikuar me një ulje prej 10 milion lekë në krahasim me vitin 2025.

Me ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Prokuroria e Përgjithshme”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2023, janë miratuar për një program buxhetor:

01110 - Planifikim, Menaxhim dhe Administrim, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme.

Raporti i shpenzimeve të programeve, sipas artikujve për vitin 2023.

Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim.

<i>Programi</i>	<i>Buxheti i fillimit të viti 2023</i>	<i>Buxheti i rishikuar vjetor 2023</i>
01110	2,620,500	3,505,772

Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik paraqitur në **Aneksin 1.4** ‘Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik për vitin 2023’ bashkangjitur Raportit të Auditimit.

- Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2023, buxheti i grupit buxhetor është rishikuar, paraqitur në **Aneksin 1.5** “Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2023” bashkangjitur Raportit të Auditimit.

Investimet:

Shpenzimet kapitale në planin fillestar janë në vlerën 210,000 lekë. Në planin e rishikuar vlera për vitin 2023 është 144,400,000 lekë, paraqitur në **Aneksin 1.6** “Projekte me financim të brendshëm” bashkangjitur Raportit të Auditimit.

**Konstatim:**

Në kërkesat e PBA 2024- 2026, në të dy fazat nuk janë paraqitur kërkesat e detajuara mbi investimet e planifikuara sipas kërkesave nga prokuroritë por janë përfshirë në Prokurorinë e Përgjithshme si një vlerë totale, vetëm duke përcaktuar emërtimin e projektit. Në vazhdimësi formati i investimeve të planifikuara të paraqitet më i detajuar duke specifikuar emërtimin e projektit për cilën prokurori është planifikuar investimi.

Raportet e monitorimit:

Për vitin 2023 Prokuroria e Përgjithshme i ka dërguar 3 raporte monitorimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme së Buxhetit:

- ✓ 4 mujorin e parë të vitit 2023 datë 18.05.2023,
- ✓ 8 mujorin e dytë të vitit 2023 datë 27.09.2023.

## 2.2 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar.

Formati 2: Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare.

Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto.

Formati 5: Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre.

Formati 7: Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve).

Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

### a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.



Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore. Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

- për vitin 2022 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 291/101, datë 27.03.2023 “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022” për Aparatin Prokurorisë së Përgjithshme, duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se:

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

Pasqyrat Financiare të konsoliduara janë raportuar në Ministrinë e Financave me nr. 291/27, datë 28.04.2023.

## **b. Saktësia dhe rregullueshmëria e pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara.**

### **Auditimi i llogarive performancës financiare**

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirmo rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2022 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2)	= 303,289 mijë lekë
ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2)	= 306,538 mijë lekë
iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85)	= (3,249) mijë lekë
Totali ii + iii	= 0 lekë

Nga auditimi i zërave të shpenzimeve rezulton se në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës” është pasqyruar dhe reflektuar ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën prej (3,249,377) lekë, veprime në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika “Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve.

### **Nga auditimi i shpenzimeve në “Pasqyra e Performancës” rezultoi:**

Të ardhurat e vitit ushtimor janë:

Të ardhura nga “Grant korent i brendshëm” në shumën prej 303,288 mijë lekë, nga të cilat “Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)” në vlerën 283,690 mijë lekë dhe “Financim i pritshëm nga buxheti” në vlerën 19,598 mijë lekë, vlerë e cila rakordon me llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor”, e cila përfaqëson detyrimet që ka PP ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2023.

Në lidhje me raportimin e shpenzimeve në “Pasqyra e Performancës” për llogarinë 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”; llogarinë 601 “Kontribute të sigurimeve”, llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime” rezultoi se janë njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, sipas përcaktimeve të nenit 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

### **Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.**

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 45% të vlerës totale të aktivit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 54% të totalit.

### **Aktivet qarkulluese**

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra, paraqitur në **Aneksin 2.1 “Aktivet qarkulluese”** bashkangjitur Raportit të Auditimit.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën 22,615,631 lekë përfaqëson gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të

tilla në llogaritë e grupit 466) në vlerën 13,835,631 lekë dhe 8,780,000 lekë është e ardhur e trashëguar, e cila ka të bëjë me grant nga Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

Pika 50 e udhëzimit. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordimin me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2022 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2022 reflekton me rritje prej vitit 2021 në vlerën 3,207,050 lekë, e cila vjen nga 5% i garancisë së mbajtur për “Rikonstruksionit të Godinës së Gjykatës së Rrethit Kukës”.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2022, rezulton në vlerën 24,731,277 lekë. Në krahasim me vitin 2021 është ulur në vlerën 3,249,377 lekë, ku peshën më të madhe e zë ulja e zërit “Materiale”, diferenca e cila është pasqyruar në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

### **Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.**

#### **\* Llogari të arkëtueshme:**

- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 140,937 lekë, përbëhet nga detyrimi të personelit, paradhënie të muajit Nëntor 2022 në vlerën 70,571 lekë dhe të muajit Dhjetor datë 30.12.2022 në vlerën 70,366 lekë, të cilat janë mbyllur në janar të vitit 2023.

#### **\* Situata e Detyrimeve të Prapambetura:**

Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 3,803,861 lekë, shifër kjo e njëjtë me atë të një viti më parë, ku nga PP sqaron se:

Janë debitorë të trashëguar që prej vitit 2002. Nga PP është bërë identifikimi i të gjithë debitorëve (si ata fizike dhe ish punonjës edhe subjekte juridike) sipas vjetërsisë dhe u janë dërguar disa herë shkresa zyrtare personave fizike si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Gjithashtu duke parë se ska asnjë mundësi reale për arkëtimin e këtyre debitorëve PP i është drejtuar zyrtarisht edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për hapat që do të ndiqen.

Nga MFE është kthyer përgjigje me shkresën nr. 15382/1, datë 09.10.2021, (prot., 1296/1, datë 11.10.2021) ku sqaron se:

Në vijim të shkresës me nr. 1296, prot., datë 08.09.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, ku kërkohet mendim mbi mënyrën e procedimit në lidhje me debitorët pa shprese arkëtimi sqarojmë se: Pasi nga ana juaj është vërtetuar dhe dokumentuar se janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për arkëtimin e të drejtave nga debitorët si dhe është vërtetuar dhe dokumentuar pamundësia e arkëtimit të këtyre të drejtave nga institucioni, debitorët pa shpresë arkëtimi të hiqen nga Pasqyrat Financiare dhe për efekt informacioni të mbahen në një regjistër specifik.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm”
<b>Situata:</b>	Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 3,803,861 lekë, shifër kjo e njëjtë me atë të një viti më parë, ku nga PP sqaron se: Janë debitorë të trashëguar që prej vitit 2002. Nga PP është bërë identifikimi i të gjithë debitorëve (si ata fizike dhe ish punonjës edhe subjekte juridike) sipas vjetërsisë dhe u janë dërguar disa herë shkresa zyrtare personave fizike si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga ana Institucionit për debitorët ish-punonjës nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, si rrjedhojë ky detyrim është i

	<p>paarkëtushëm, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203 pika 1 Kodi i Punës “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe neni 115 Kodit Civil “Parashkruhen brenda afateve prej dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.</p> <p>- Në lidhje me detyrimet ndaj personave fizike dhe subjekteve juridike, të krijuat para vitit 2002 bazuar në Kodin Civil, neni 114 ”Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” ky detyrim është i parashkruar.</p>
<b>Kriteri:</b>	Kodi i Punës, nenin 203 pika 1 “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet” si dhe Kodit Civil neni 115, 114 dhe 121.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Detyrime të cilat nuk kanë shpresë arkëtim, pasi ka humbur fuqia ligjore për ti kërkuar.
<b>Shkaku:</b>	Mos marrja e hapave ligjor me kohë për të parandaluar parashkrimin tyre sipas përcaktimeve në Kodin civil dhe Kodin e punës.
<b>Rëndësia:</b>	E ulët.
<b>Rekomandimi:</b>	Spektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkruara dhe të paarkëtueshëm, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, në vlerën 5,034,964 lekë. Kjo vlerë përfaqëson shumën e detyrimit për dy fatura ndaj “Institutit të ndërtimit” në 2021 dhe vlera 848,411 lekë e krijuar 2022.

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 19,598,339 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka PP ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2023 të cilat janë kredituar në llogarinë 401 në shumën prej 467,436 lekë dhe në llogarinë 467 në shumën prej 1,913,758 lekë.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor”.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i zërave të kontabilizuar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është regjistruar dhe vlera e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në shumën prej 467,436 lekë.</p> <p>Këto detyrime janë të trashëguar, që përpara vitit 2010, duke humbur statusin e detyrimeve afatshkurtra, sipas përcaktimit të Udhëzimit nr. 8 pika 3.2 “3.3 Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”. Sa më sipër debitimi i shumës prej 467,436 lekë në llogarinë 4342 është në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.2.</p> <p>Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” përfaqëson burime</p>

	<p>financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor), që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.</p> <p>Sa më sipër vlera prej 467,436 lekë e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, duhet të ishte debituar në llogarinë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mospasqyrimi i saktë i llogarive në pasqyrën financiare jep një pamje jo të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit, me ndikim material në rezultatin e institucionit.
<b>Shkaku:</b>	Mospasqyrimi i drejtë i llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e shumës prej 467,436 lekë, duke e kryer veprimin kontabël duke debituar llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” dhe duke kredituar llogarinë përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

### Aktivet afatgjata

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Afatgjata” në vlerën neto prej 579,449 mijë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “Aktive Afatgjata jo materiale” në vlerën neto 379,850 lekë dhe “Aktive Afatgjata materiale” në vlerën neto 579,069 mijë lekë, paraqitur në *Aneksin 2.2* “Aktivet afatgjata” bashkangjitur Raportit të Auditimit.

- Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 151,494,022 lekë. Gjatë vitit ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 1,745,279 lekë dhe zvogëlim nga nxjerrja jashtë përdorimi në vlerën bruto prej 13,795,171 lekë.

Nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi në procesverbalin e mbajtur me nr. 987/1, datë 15.07.2022, ku është relatuar procesi i asgjësimit është cituar se:

Nga vlerësimi për dalje jashtë përdorimi të vlerës 13,795,031 lekë, nga kjo shumë të rikthehen në gjendje pune vlera 1,745,279 lekë “Punime për godinën e vendrojes dhe ambiente Zyre”, vlera të cilat janë reflektuar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)”.

- Llogaria 213 “Rruge,rrjete,vepra ujore”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 60,628,134 lekë. Gjatë vitit ka pësuar ulje në vlerën bruto prej 783,100 lekë, si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të rrjetit kompjuterik, i cili është zëvendësuar tërësisht me kabllim të ri dhe gjithë rrjeti kabllor i vjetër është nxjerrë jashtë përdorimi.

- Llogaria 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 113,643,907 lekë.

Gjatë vitit ka pësuar rritje në vlerën bruto prej 3,439,374 lekë dhe zvogëlim nga nxjerrja jashtë përdorimi në vlerën bruto prej 217,595,253 lekë dhe kalim aktivi pa pagesë në vlerën 18,207,868 lekë.

- Kalim kapitali pa pagesë nga PP tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Me urdhrin e Sekretarit të përgjithshëm me nr, 28, datë 18.03.2022 “Mbi dhënien pa pagesë të aktiviteteve”, bazuar në shkresën me nr, 913 Prot, datë 27.01.2022 mbi “Kërkesën për mbështetje” të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve” është bërë kalimi i aktiveve nga PP tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve” bërë dalje me Fletë-daljen me nr.4, datë 18.03.2022 në vlerën 274,960 lekë.

- Kalim kapitali pa pagesë nga PP tek Ministria e Mbrojtjes:

Me urdhrin e përbashkët me nr. 460, datë 08.04.2022 të Ministrisë së Mbrojtjes me nr. 1840 prot., datë 08.04.2022 dhe Prokurorisë së Përgjithshme me nr. 471 prot, datë 08.04.2022 “Për kalimin Kapital Agregati Gjenerator/Agreat me Fuqi 100 KW” është bërë kalimi i “Gjenerator Agregat me fuqi 100 Kx” në vlerën 15,467,672 lekë.

Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosur Reparti Ushtarak nr. 6640 me nr.19/4 Prot., datë 19.05.2022 ka nxjerr autorizimin për tërheqjen e materialeve. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosur ka nxjerr urdhrin me nr. 440, prot., nr. 3073, datë 16.05.2022 “Për marrjen kalim Kapital Agregati (Gjenerator /Agreat me fuqi 100 KW)”. Me datë 19.05.2022 është mbajtur proces verbalin i marrjes në dorëzim të aktivitetit nga të dy institucionet. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosur, Reparti Ushtarak nr.6640 me nr. 485/2 Prot, datë 26.05.2022 ka dërguar konfirmim –marrjes, si dhe Fletë hyrjen e aktivitetit me nr. 5, datë 19.05.2022.

- Kalim kapitali pa pagesë nga PP tek SPAK:

Me urdhrin e 97182/2, datë 23.11.2022 “Për kalimin Kapital” të:

- Central telefonik, copë 1 në vlerën 1,000,000 lekë

- Telefon copë 120, në vlerën 600.000 bërë dalje me Fletë dalje me nr. 30, datë 30.11.2022 në total 1,600,000 lekë.

Nga auditimi u konstatua se kalimi ka të bashkëngjitur dokumentacion, sic janë procesverbali i marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga PP deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu dhe Fletë hyrjen e mallrave në magazinë nga institucioni përfitues me nr. 60, datë 09.12.2022.

Nga auditimi u konstatua se kalimi ka të bashkëngjitur dokumentacion, sic janë procesverbali i marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga PP deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu dhe Fletë hyrjen e mallrave në magazinë nga institucioni përfitues.

- Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 30.05.2022 ka bërë kërkesën për pajisje me kondicionerë, për Prokurorinë e Rrethit Tiranë shkresë e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i PP.

Nga PP është bërë Fletë dalja me nr. 10, datë 30.05.2022 në shumën 48,000 lekë dhe nga Prokuroria e Rrethit Tirane është dërguar Fletë hyrja me nr. 24, datë 30.05.2022.

-Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 22.06.2022 ka bërë kërkesën për pajisje me 2 kondicionerë, për Prokurorinë e Shkallës së Para Rrethit Durrës shkresë e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i PP.

Nga PP është bërë Fletë dalja me nr. 12, datë 22.06.2022 në shumën 92,400 lekë dhe nga Prokuroria e Shkallës së Para Rrethit Durrës është dërguar Fletë hyrja me nr. 20, datë 25.07.2022. Në kontabilitet vlera 32,400 lekë është pasqyruar dalje në llogarinë 218, ndërsa vlera prej 60,000 lekë është pasqyruar në llogarinë 214.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë me shkresën nr. 6833 Prot, datë 11.05.2022 ka bërë kërkesën për kondicionerë.

Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 22.06.2022 ka bërë kërkesën për pajisje me 7 kondicionerë, për Prokurorinë e Shkallës së Parë, Rrethit Tiranë shkresë e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i PP.

Nga PP është bërë Fletë dalja me nr. 13, datë 22.06.2022 në shumën 408,000 lekë dhe nga Prokurorinë e Shkallës së Para Rrethit Tiranë është dërguar Fletë hyrja me nr. 27, datë 22.06.2022.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me shkresën nr. 5028 Prot, datë 23.06.2022 ka bërë kërkesën për kondicioner.

Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 23.06.2022 ka bërë kërkesën për pajisje me kondicioner, për Prokurorinë e Shkallës së Parë, Rrethit Fier shkresë e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i PP.

Nga PP është bërë Fletë dalja me nr. 14, datë 24.06.2022 në shumën 50,970 lekë dhe nga Prokurorinë e Shkallës së Parë Rrethit Fier është dërguar Fletë hyrja me nr. 1, datë 24.06.2022.

Për sa më sipër të gjitha praktikatat, nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga PP deri në momentin e daljes nga pronësia.

-Nga PP është bërë dalje me Fletë dalje me nr.15, datë 29.06.2022 të një Kondicioneri në vlerën 50,970 lekë tek Prokuroria e Rrethit Vlorë. Bashkëngjitur është vetëm Fletë hyrja me nr.20, datë 05.07.2022, dhe urdhër furnizimi. Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur miratimin për kalim kapitali, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga PP deri në momentin e daljes nga pronësia.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 16,114,203 lekë.

Gjatë vitit ka pësuar ndryshime nga:

- Blerjet e realizuara në shumën prej 13,200,000 lekë.

Artikulli	FH	Subjekti Blerës	Vlera
Automjete TUCSON	nr.4, datë 30.11.2022	A. M., C.	3,300,000
Automjete TUCSON	nr.5, datë 30.11.2022	A. M., C.	3,300,000
Automjete TUCSON	nr.6, datë 30.11.2022	A. M., C.	3,300,000
Automjete TUCSON	nr.7, datë 30.11.2022	A. M., C.	3,300,000

**Rezultoi se**, për hyrjet e automjeteve, në Fletëhyrjen e magazinës mungon dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, garanci malli etj., por te gjitha janë lidhur ne urdhër shpenzimin e likujdimit të mbajtur nga financa. Magazina duhet të mbajë bashkëlidhur faturën dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim sipas përcaktimeve me pikën 37 dhe 54 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, pasi mungon “Gjurma e auditimit”, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

**“Kalimit kapital pa pagesë”:**

**Rritje:**

- Me Urdhrin me nr. 29 Prot, datë 13.01.2022 nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar “ Mbi transferimin kapital pa pagesë të një automjeti të Prokurorisë së Posçmë Kundër Korrupsionit dhe Krimin te Organizuar” tek Prokuroria e Përgjithshme të një “Automjet tip Land Rover Defender” në vlerën 1,242,800 lekë.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar me nr. 1239 Prot., datë 14.02.2022 ka dërguar Fletë daljen për dhurimin e automjetit tip Land Rover Defender.

Nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është mbajtur proces verbali “Për dorëzimin e një automjetit”, me personin e autorizuar nga PP, bazuar në autorizimin me nr.28/2 Prot, date 24.01.2022 Sekretari i Përgjithshëm “për marrjen në dorëzim të automjetit”.

Nga PP është bërë hyrja me Fletë – hyrjen me nr. 5, datë 17.02.2022.

- Nga Sekretari i Përgjithshëm i PP ka dalë urdhri nr, 1, datë 07.01.2022 “Për Transferimi AAM, duke marrë parasysh nevojën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë” për kompletimin me automjete të një “Autoveturë tip Benz Vito” në vlerën 273,293 lekë.

Me shkresën me nr. 143 Prot., datë 12.01.2022, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë “Për Transferimin e Aktiveve Afatgjata Materiale” është dërguar informacioni në lidhje me automjetin si: kartela shoqëruese e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar, Fletë dalja e automejtit me nr. 2, datë 12.01.2022, si dhe Leje Qarkullimi.

- Kalim i Autoveturë Hyundai Tuscon nga Prokuroria e Rrethit Tiranë.

Bashkëlidhur janë vetëm Fletë- hyrje me nr.7 datë 05.05.2022 e PP dhe Fletë dalja fatura me nr. 13 datë 05.05.2022, Prokuroria e Rrethit Tiranë në vlerën 2,499,600 lekë.

Konstatim: Mungon dokumentacioni si urdhri për kalim kapitali, autorizimi i tërheqjes së aktivitetit, procesverbali i marrjes në dorëzim, kartela shoqëruese e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar.

### **Zvogëlimi:**

Me Urdhrin me nr, 40, datë 05.05.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm i PP “Për transferimin AAM” duke marrë parasysh nevojat e kompletimit të prokurorive me automjet të bëhet kalimi i Autoveturës Hyundai Tuscon në vlerën 2,499,600 lekë tek Prokuroria e Rrethit Tiranë, bazuar në shkresën e Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë PP, datë 04.05.2022, i cila ka bërë kërkesën për transferim pa pagesë të automjetit tek PGJSHP Tiranë. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë me datë 16.05.2022 ka nxjerr autorizimin për të bërë veprimet pranë Prokurorisë së Përgjithshme, për tërheqjen e automjetit.

Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 05.05.2022 ka mbajtur proces verbalin për dorëzimin se bashku me dokumentacionin përkatës të automjetit.

Bashkëlidhur është Fletë dalje me nr. 6, datë 5.05.2022, si dhe Fletë hyrja me nr. 22, datë 06.05.2022 e Prokuroria e Rrethit Tiranë, **por mungon kartela shoqëruese e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe vlerës së mbetur të aktivitetit.**

- Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerr urdhrin me nr. 11, datë 03.02.2022 ”Mbi dhënien pa pagesë të I ( një ) automjeti Audi Q 7” në vlerën 1,080,103 lekë, përfitues Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila ka dërguar shkresën me nr, 913 Prot, datë 27.01.2022 mbi “Kërkesën për mbështetje”.

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nxjerre autorizimin me nr. 913/1 prot, datë 03.02.2022, për marrjen e automjetit të dhuruar si donacion.

-Nga PP është mbajtur proces verbali me datë 03.02.2022. “Mbi marrjen në dorëzim të një automjeti në pronësi të Prokurorisë së Përgjithshëm “

Bashkëlidhur është Fletë dalje –fatura nr.2, datë 04.02.2022, si dhe Fletë hyrja me nr.1, datë 04.02.2022 e DPB, **por mungon kartela shoqëruese e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe vlerës së mbetur të aktivitetit.**

- Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerr urdhrin me nr.11, datë 18.02.2022 ”Mbi dhënien pa pagesë të I (një) Automjeti tip BMV” në vlerën 1,829,988 lekë, përfitues Garda e Republikës, e cila ka dërguar shkresën me nr. 262 Prot, datë 11.02.2022 mbi “Transferimin pa pagesë të një mjeti”.

- Garda e Republikës ka nxjerre autorizimin me nr.262/1 prot, datë 18.02.2022, për marrjen e automjetit të dhuruar si donacion.

-Nga PP është mbajtur proces verbali me datë 18.02.2022 “Mbi marrjen në dorëzim të një automjeti në pronësi të Prokurorisë së Përgjithshëm“.



Bashkëlidhur është Fletë dalje –fatura nr.3, datë 18.02.2022, si dhe Fletë hyrja me nr.2, datë 18.02.2022 e Gardës së Republikës, **por mungon kartela shoqëruese e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe vlerës së mbetur të aktivit.**

- Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerr urdhrin me nr. 01, datë 07.01.2021 "*Për transferim AAM*" duke marrë parasysh nevojën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë për kompletimin me automjete". Në urdhrë është cituar kalimi i dy automjeteve:

- Benz Vito AA-----O dhe Mercedes Bens TR-----R

- Nga PP është mbajtur proces verbali datë 13.01.2022 "*Mbi dorëzimin e një automjeti në pronësi të Prokurorisë së Përgjithshme*" tip Mercedes Bens TR----R në vlerën 583,326 lekë.

Bashkëlidhur është Fletë dalje me nr.1, datë 13.12.2022, si dhe Fletë hyrja me nr.1, datë 13.12.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë, **por mungon kartela shoqëruese e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe vlerës së mbetur të aktivit.**

- Sekretari i përgjithshëm i PP ka nxjerr urdhrin nr, 109/1, datë 02.12.2022, "*Për transferimin AAM*", (duke marrë parasysh nevojat e kompletimit të prokurorive me automjet), për kalim kapitali të automjetit tip "TUCSON" me vlerë 3,300,000 lekë.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë me nr. ekstra, prot, datë 02.12.2022 ka nxjerr autorizimin për kryerjen e të gjithave veprimeve në Prokurorinë e Përgjithshme për tërheqjen e një automjeti për llogari të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës se Parë Tiranë. Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 02.12.2022 ka mbajtur proces verbalin për dorimin së bashku me dokumentacionin përkatës të automjetit. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë me shkresën nr. 1798 Prot, datë 16.12.2022 ka bërë shkresën "*Mbi transferimin pa pagesë të një mjeti*" bashkëlidhur Fletë hyrja me nr. 57 datë 02.12.2022.

- Llogaria 218 "Inventar ekonomik", paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 75,833,773 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat:

- Blerjeve të realizuara gjatë vitit në vlerën 23,540,524 lekë.

- Kalimit kapital pa pagesë në vlerën prej 19,286,080 lekë.

- Zvogëlim në vlerën në vlerën 5,065,122 lekë.

### ***Kalim kapitali pa pagesë nga PP:***

#### **Dalje**

- Me urdhrin e Sekretarit të përgjithshëm me nr, 28, datë 18.03.2022 "*Mbi dhënie pa pagesë të aktiviteteve*", bazuar në shkresën me nr, 913 Prot, datë 27.01.2022 mbi "*Kërkesën për mbështetje*" të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve" është bërë kalimi i aktiveve nga PP tek Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve" bërë dalje me Fletë-daljen me nr.4, datë 18.03.2022 ne vlerën 934,696 lekë.

- Me urdhrin e Sekretarit të përgjithshëm është bërë kalimi i dy kamerave të brendshme, në Gjykatën e Shkallës së Parë, Elbasan, bazuar në kërkesën për plotësimin e nevojave nga kjo gjykatë. Nga PP është bërë Fletë dalja me nr. 5, datë 19.04.2022 në shumën 247,296 lekë dhe nga GJSHP Elbasan është dërguar Fletë hyrja me nr. 1, datë 19.04.2022.

-Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 26.05.2022 ka bërë kërkesën për padisje me kompjuter dhe monitor, për Prokurorinë e Rrethit Vlorë, e cila është miratuar nga Sekretari i përgjithshëm i PP.

Nga PP është bërë Fletë dalja me nr. 9, datë 22.05.2022 në shumën 67,000 lekë dhe nga Prokuroria e Rrethit Vlorë është dërguar Fletë hyrja me nr. 17, datë 30.05.2022.

- Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse me datë 17.06.2022 ka bërë kërkesën për pajisje me 3 kondicionerë, për Prokurorinë

e Rrethit Kukës shkresë e cila është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i PP.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se Fletë dalja e PP me nr. 11, datë 17.06.2022 dhe Fletë hyrja e Prokurorisë së Rrethit Kukës me nr, 7, datë 17.06.2022, ***citojnë se janë bërë kalime për Kompjuter dhe monitor në vlerën 205,240 lekë.***

- Me urdhrin e Sekretarit të përgjithshëm është bërë kalimi i “Telefon IP Cisco 7942G”, në Prokuroria e Rrethit Lushnje, bazuar në kërkesën për plotësimin e nevojave. Nga PP është bërë Fletë dalja me nr. 7, datë 19.05.2022 në shumën 39,519.48 lekë dhe nga Prokuroria e Rrethit Lushnje është dërguar Fletë hyrja me nr. 1, datë 19.05.2022

***Për sa më sipër të gjithë praktikat, nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga PP deri në momentin e daljes nga pronësia, si dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim të aktiveve.***

Nga PP janë bërë dalje nga llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitur në ***Aneksin 2.3 “Dalje e Aktibebe AGJ nga llogaria 218”*** bashkangjitur Raportit të Auditimit.

*Për të gjithë lëvizjet e në tabelën sa më sipër: nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur miratimin për kalim kapitali, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga PP deri në momentin e daljes nga pronësia, si dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim të aktiveve.*

### **Hyrje:**

-Nga sekretari i përgjithshëm me nr.1519/1 Prot, datë 23.11.2022, është dërguar urdhri nr.127, datë 18.11.2022, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për dakortësinë e kalimit të “Telefonave Voip Cisco 7942”. Me nr. 775 Prot., datë 30.11.2022, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka nxjerr urdhrin me nr, 775, datë 30.11.2022, “Për dhënien pa pagesë të aktiviteteve”.

Në dosje është Fletë hyrja e PP me nr.8 datë 13.12.2022 në vlerën 2,271,084 dhe Fletë dalja nga SPAK me nr. 114 datë 13.12.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga SPAK deri në momentin e daljes nga pronësia, si dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim të aktiveve. Gjithashtu në kontabilitet janë regjistruar me vlerën historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës reale të aktiveve neto gjendje të institucionit.*

-Fletë hyrje me nr.1, datë 14.09.2022 të Prokurorisë së Përgjithshme për pajisjet e marra nga Apeli Tiranë shoqëruar me Fletë dalje me nr.52, datë 14.09.2022:

“Kompjuter, Optiplex” në vlerën 177,600 lekë dhe “Optilex 3010” në shumën prej 120,240 lekë, në total 297,900 lekë.

*Sa më sipër nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur, autorizimin dhe për kalim kapitali pa pagesë, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga institucioni që ka bërë kalim kapitali, deri në momentin e daljes nga pronësia, si dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim të aktiveve. Gjithashtu në kontabilitet janë regjistruar me vlerën historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës reale të aktiveve neto gjendje të institucionit.*

- Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është mbajtur proce verbali me datë 05.01.2022, “Mbi marrjen në dorëzim të pronësisë së aseteve të dhuruara nga E-----”.

Nga sekretari i Përgjithshëm ka dalë urdhri nr. 98, datë 31.12.2021 “Për kalimin në pronësi të Prokurorisë së Përgjithshme (për transferim asetesh pa pagesë) nga E.....S V”.

Me shkresën me nr. 82 Prot., datë 30.12.2021 nga E. është dërguar marrëveshja me nr. 82, datë 30.12.2021 për transferim asetesh nga E. V. bashkëngjitur dokumentacionit të transferimit janë Asetet dhe Licencat që E. ka blerë për përdorimin të stafit të Prokurorisë së Përgjithshme, Faturat tatimore. Asetet janë bërë hyrje me Fletë hyrjen me nr.1 datë 05.01.2022 në vlerën 5,633,889 lekë, pas marrjes në dorëzim të tyre nga komisioni i marrjes në dorëzim të aseteve.

- Nga Prokuroria e Përgjithshme me nr.53, datë 14.01.2022 është lidhur marrëveshja me V.... A.... SH.A, ku ofron vlerën 184,990 lekë. Nga Sekretari i Përgjithshëm ka dalë urdhri me nr. 8, datë 27.01.2022, “Për kalimin në pronësi të Prokurorisë së Përgjithshme (transferim pa pagesë) nga V. A. SH.A”.

-Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është mbajtur proces verbali me datë 27.01.2022 “Mbi marrjen në dorëzim të një telefoni celular Apple Iphone 13 transferuar në Prokurorinë e Përgjithshme pa pagesë”, të cilat janë të shoqëruara me Fletë garancie dhe faturat tatimore. Më pas është bërë hyrja në magazinë me Fletë hyrjen me nr. 3, datë 27.01.2022 në vlerën 184,990 lekë.

- Me nr, 1724, datë 13.12.2021 është lidhur Kontrata e Dhurimit midis bankës C. sh.a dhe Prokurorisë e Përgjithshme Tiranë.

1. Objekti i kontratës është dhurimi i pajisjeve për mobilimin e zyrave të pranuesit të dhurimit sipas faturës tatimore të lëshuar nga furnizuesi.

2 Dhuruesi i dhuron pa kundër shpërblim pranuesit të dhurimit, sendet me të gjitha të dhënat e përshkruara si më sipër të kësaj kontrate. Pranuesi pranon dhurimin e sendeve me të dhënat e sipërshënuara. Bashkëngjitur faturat tatimore.

Nga Sekretari i Përgjithshëm ka dalë urdhri nr.10, datë 02.02.2022 “Për Kalimin në Pronësi të Prokurorisë së Përgjithshme të Pajisjeve për Mobilimin e Zyrave (sipas zërave të faturës tatimore të shitësit)”.

-Nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është mbajtur proces verbali me datë 02.02.2022 “Mbi marrjen në dorëzim të artikujve të dhuruarve për mobilimin e zyrave”, bashkëlidhur faturat tatimore në shumën total 3,675,000 lekë. Më pas është bërë hyrje me Fletë hyrje nr. 4, datë 02.02.2022 të pajisjeve të zyrës në vlerën 3,675,000 lekë.

Kalim kapitali nga Prokuroria e Gjykatës së shkallës së parë Elbasan të pajisjeve kompjuterike shoqëruar me urdhrin për dërgim materialesh me nr. 9728, datë 01.09.2022 dhe Fletë daljen me nr. 3, datë 21.09.2022 në shumën prej 516,830 lekë. Nga PP janë bërë hyrje në magazinë të aktiveve, të pashoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim. Gjithashtu mungon kartela shoqëruuese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga institucioni që ka bërë kalim kapitali, deri në momentin e daljes nga pronësia, por janë regjistruar me vlerën historike.

- Nga Sekretari i Përgjithshëm ka dalë urdhri me nr. 11, datë 03.02.2022 “Për krijimin e Komisionit të Përcaktimit të Vlerës së Gjeneratorit Pjesë e Donacionit nga M. e B. viti 2008”. Me nr. Ekstra Prot, E.Z. datë 10.02.2022 nga Komisioni i Vlerësimit është mbajtur proces verbali “Për Vlerësimin e Akteve Materiale”, ku citon mënyrën e ripërlllogaritjes së vlerës së gjeneratorit bazuar në çmimet në internet si dhe çmimet mesatare të tregut për këtë tip gjeneratori duke përllogaritur në vlerë prej 873,270 lekë. Nga PP është bërë hyrje të shumës së aktivitetit me Fletë hyrjen me nr. 1 datë 10.02.2022.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Kalim kapitali pa pagesë i aktiveve.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një subjekt në tjetrin në disa praktika u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur miratimin për kalim kapitali, autorizimi i tërheqjes së aktivitetit, procesverbali i marrjes në

	<p>dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga institucioni që ka bërë kalim kapitali, deri në momentin e daljes nga pronësia, ku vlera e këtyre aktiveve të transferuara janë regjistruar me vlerën historike nga institucionet përfituese, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës reale të aktiveve neto.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, në kapitullin III të udhëzimit “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos llogaritje e vlerës së mbetur të aktivitetit, çon në regjistrimin e vlerës jo reale të aktivitetit. Mos dokumentimi i transferimit të aktiveve, le të hapur ciklin e transferimit të kapitali.
<b>Shkaku:</b>	Mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Sektori i financës të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktiveve në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mos klasifikimi i aktiveve sipas llogarive të përcaktuara në planin kontabël publik, si dhe mospaqyrimi i saktë i formatit 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme”.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit dhe regjistrimit për vitin 2022 u konstatua se, një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 2187 “Te tjera pajisje zyre” dhe jo në llogarinë 218600 “pajisjeve elektronike”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Klasa 2 “Aktive afatgjata” dhe pika 36 “Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata”, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.</p> <p>- Një pjesë e “Pajisjeve dhe instalimi i kondicionerëve” janë klasifikuar në llogarinë 218700 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, por pa ndikim në vlerën neto të aktiveve pasi normat e amortizimit është 20% për të dy klasifikimet.</p> <p>- Nga auditimi u konstatua se institucioni pas procesit të vlerësimit ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivitetet e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën prej 9,137,662.9 lekë. Nga PP këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” , si dhe Udhëzimit me nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109.</p>

	<p>Aktivet kalojnë në llogarinë 24 “Aktive të Qend.të trupëzuara te dëmtuara” pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një Fletë hyrje rikupero.</p> <p>- Në procesverbalin me nr. 987/1, datë 15.07.2022 të mbajtur nga komisioni “Për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi” është propozuar që:</p> <p>- Për tre artikuj “Orendi zyre” në vlerën 136,282 lekë komisioni ka propozuar kthimin e tyre në magazinë dhe sipas kërkesave dhe nevojave të transferohen brenda institucioneve të varësisë.</p> <p>- Për artikullin nr. A0168 “APC Netsheld” në vlerë 110,00 lekë, ka propozuar kthimin e tij në inventarin e institucionit edhe pse nuk ka funksion primar, por ka informacion CAMS e cila në cdo moment shërbejnë për Back Up.</p> <p><b><i>Nga institucioni nuk është bërë Fletë hyrje dhe as asgjësim i tyre.</i></b></p> <p>Pra vlera prej 246,282 lekë duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” ose në llogarinë 24 “Aktive të Qend.te trupëzuara te dëmtuara”.</p> <p>- Për artikujt A10588; A0215 dhe A0789 në vlerë totale 314,617.41 lekë, që komisioni ka vendosur të mos asgjësohen, por ti kalojnë për skrap Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, kjo vlerë është hequr nga kontabiliteti dhe nuk është reflektuar në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” (me koston historike) llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën neto deri në momentin e transferimit.</p> <p>Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109.</p> <p>Prokuroria e përgjithshme deri në realizimin e transferimit të tyre tek DPRSH, vlera prej 314,617,41 lekë duhet të ishte kontabilizuar në llogarinë 24 “Aktive të Qend.te trupëzuara te dëmtuara”, pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një Fletë hyrje rikupero.</p> <p>Për vitin 2022, në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” (me koston historike) duhet të ishin reflektuar këto aktive si nxjerrje jashtë përdorimi, duke debituar llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën neto, por pa ndikim në rezultatin financiar të vitit 2022.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36;</p> <p>Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Mos evidentimi i saktë i vlerës neto të aktiveve që disponon institucioni, e cila ndikon në mos Planifikimi e saktë të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.</p>

<b>Shkaku:</b>	Trashëguar në vite mënyra e mbajtjes dhe regjistrimit të aktiveve në kontabilitet.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	- Sektori i Financës së PP të marri masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve. - Sektori i Financës së PP të marri masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive te Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi deri në momentin e asgjësimit apo te tjetërsimit të tyre.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Vlera e mbetur e aktiveve afatgjata.
<b>Situata:</b>	- Nga auditimi i regjistrit të aktiveve te regjistruar në kontabilitet u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite vlera e tyre është papërfillshme ose 0. Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune. Nga institucioni nuk janë marrë masa për të ngritur grupe e pune me ekspertë të fushave, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 103, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 33.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 103, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 33.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrim i saktë i vlerës së aktiveve, gjendje në institucion.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e VKM-së të miratuar, për mënyrën e rivlerësimit të aktiveve.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	- NA duhet të ngrejë një komision me ekspertë të fushave, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Mbi bazën e aktit të rivlerësimit, institucioni të realizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.

### Pasivet Afatshkurtra

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2022, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 1,025,725 mijë lekë. paraqitur në **Aneksin 2.5** “Pasivet Afatshkurtra” bashkangjitur Raportit të Auditimit.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën 467,436 përfaqëson detyrime ndaj palëve të treta për blerje mallra e shërbime të cilat janë të trashëguara ndër vite.

#### **Sa më sipër:**

- Në lidhje me detyrimet ndaj personave fizike dhe subjekteve juridike, të krijuat para vitit 2010, bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” ku citon se “Kur në ligj nuk është

parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës” ky detyrim është i parashkruar.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 11,625,705 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2022, që paguhen në janar të vitit 2023.

- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 1,636,884 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit dhjetor 2022, të cilat paguhen në janar të vitit 2023.

- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 3,438,638 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 515,918 lekë të muajit dhjetor 2022, të cilat paguhen në muajin Janar 2023.

- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 3,945,498 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përbëhet nga saldo debitorë të llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”; llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” dhe të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

- Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” në shumën prej 629,118,907 lekë përfaqëson 5% e garancisë së mbajtur “Rikonstruksionit të Godinës së Gjykatës së Rrethit Kukës” në vlerën 3,207,050 lekë, vlera 10,628,581 është 5% i trashëguar nga 2021 për “Rikonstruksionin e godinës së Prokurorisë së Përgjithshme” dhe shuma prej 615,283,276 lekë ka të bëjë sekuestro vlera, të cilat janë debituar në llogarinë 512 “Mjete monetare në bankë”.

- Llogaria 478 “Diferenca konvertimi pasive” është një vlerë e trashëguar ndër vite, e cila ka lindur nga vlerësimet me kurset e këmbimit në mbyllje të vitit ushtrimor (të kërkesave debitorë dhe detyrimeve) të shprehura në monedha të huaja.

Funksionimi kontabël i kësaj llogarie në momentin e konstatimit është • Kredittimi i llogarisë 478 “Diferenca konvertimi pasive” (për llogaritjen e diferencave); dhe Debitimi i klasës 4 “Të drejta”. Nga analizë e kësaj llogarie rezulton se kjo vlerë ka të bëjë me sekuestro të cilat debitohet direkt në llogarinë 512 “Mjete monetare në Bankë”.

Nga PP në momentin që është mbyllur ky detyrim nuk është bërë veprimi kontabël të kreditimit të 512 dhe debitimin e 478 “Diferenca konvertimi pasive”, por është lënë e hapur llogaria 478, vlerë e cila në rakordimin e pasivit dhe aktivitet është mbyllur me fondet neto.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Fondet e konsoliduara.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit rezultoi se: Në rubrikën D “Fondet e konsoliduar nga Institucioni” është pasqyruar llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale te Huaja” në vlerën 5,633,890 lekë.</p> <p>Nga analiza e zërave në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto llogaria 106 është pasqyruar në vlerën 0 lekë.</p> <p>Nga auditimi i hyrjeve të aktiveve pa pagesë rezultoi se vlera e paraqitur nga PP në llogarinë 105 “Teprica e Granteve kapitale Te Huaja” ka të bëjë me kalimin në pronësi të aktiveve pa pagesë transferuar nga E.V, për të cilat janë bërë hyrje në institucion me datën 05.01.2022.</p> <p>Sa më sipër nga PP duhet të ishte pasqyruar vlera 5,633,889 lekë në “Pasqyrën e ndryshimeve të aktivet neto/ fondet neto” në llogarinë 106, vlerë e cila (për grantet e përdorura për krijim aktivesh të përfunduara në vlerën 5,633,889 lekë) është njohur në momentin fillestar në llogarite e grupeve 21 të aktiveve afatgjata.</p>

	Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 1.1.2 “Funksionimi për llogaritë e tepricës së granteve kapitale të brendshme (105) dhe tepricës së granteve kapitale të huaja (llogaria 106).”.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrim të saktë të zërave në pasqyrën financiare të institucionit, e cila ndikon dhe në pasqyrimin jo të saktë të pasqyrave të konsoliduar, por pa ndikim material.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kërkesave të UMFE nr.8, date 09.03.2018, i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	- Sektori i Financës së PP të marrë masa për sistemimin e llogarive në kontabilitet duke debituar llogarinë 106 “Teprica e granteve kapitale të huaja” dhe kredituar llogarinë 1011 “Shtesa të fondit bazë”.

### Pasqyra “cash flow”

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Pasqyra “cash flow” .
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i pasqyrës së “cash flow” u konstatua se nga PP janë bërë shpenzime kapitale në shumën prej 104,904,075 lekë. Në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” nga PP janë pasqyruar rritje nga blerjet e krijuara gjatë vitit 2022 në shumën prej 36,740,524 lekë.</p> <p>Diferenca prej 68,163,551 lekë, në shënimet shpjeguese është cituar se kjo vlerë është kaluar tek Prokuroria Rrethit Kukës. Nga PP nuk ka asnjë “Gjurmë auditimi” të kalimit të këtij transaksioni. Gjurmë, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.</p> <p>Nga PP shuma prej 68,163,551 lekë duhet të ishte mbajtur debituar në llogarinë 231 “Për Aktive Afatgjata material”.</p> <p>Shuma investimi për “Rikonstruksionin e godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës” është planifikuar dhe realizuar nga Prokuroria e Përgjithshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për rrjedhim, Aktivët afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim dhe para se të bëhet miratimi i kalimit pa pagesë të vlerës së aktivitetit, detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.</li> </ul> <p>Pas marrjes në dorëzim të punimeve, ku të ketë të bashkëngjitur situacionin final, librezat e masave dhe relacionin teknik final, si dhe pas kolaudimit të ndërtesës, Prokuroria e Përgjithshme nxjerr një urdhër për kalim kapitali të vlerës 68,163,551 lekë tek Prokuroria e Rrethit Kukës, me qëllim dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi, si dhe rakordimi i pasqyrave financiare të institucionit me njëra tjetrën.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”.</p>



<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrim të saktë të zërave në pasqyrën financiare të institucionit, e cila ndikon dhe në pasqyrimin o të saktë të pasqyrave të konsoliduara.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kërkesave të UMFE nr.8, date 09.03.2018, i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	- Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa në vijimësi, që për investimet të cilat janë planifikuar dhe realizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, para se të vihen në shfrytëzim dhe para se të bëhet miratimi i kalimit pa pagesë të vlerës së aktivitetit, detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen në llogarinë 23 “Investime”, me qëllim dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi.

➤ **Pasqyrat financiare të konsoliduara të PP**

Nga auditimi i pasqyrave individuale të njërive shpenzuese rezultoi:

• **Prokuroria Rrethit Tiranë**

Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” rezultoi se për pakësimet e aktiveve në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,886,382 lekë, nga institucioni nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, *por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.*

Nga auditimi i pasqyrës së “Cash Flow” rezultoi se:

- Të hyra nga Mjetet ne ruajtje(+) janë në shumën prej 3,611,100 lekë

- Pagesat per mjetet në ruajtje(-) janë në shumën -1,209,200 lekë

Diferenca 2,401,900 lekë

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” është rritur nga viti 2021 në shumë prej 2,563,900 lekë dhe jo në shumën prej 2,401,900 lekë siç është pasqyruar nga lëvizjet në cash flow.

Diferenca prej 162,000 lekë me tepër ka të bëjë me të ardhura “Të tjera, arkëtuar (+)”, vlerë e cila nuk duhet të ishte kredituar në llogarinë 466, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrës së “Pozicionit financiar”, por pa ndikim material.

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet se nga Institucioni rezulton me detyrime të prapambetura nga viti 2021 në vitin 2022, ku sipas shënimeve shpjeguese të institucionit kjo vlerë ka të bëjë me detyrimet që institucioni ka ndaj Institutit të mjekësisë ligjore në vlerën prej 24,205,900 lekë të mbartura ndër vite, detyrim ndaj ASHK në vlerë 764,800 lekë, si dhe fatura të papaguara për honorare në shumën prej 2,986,000 lekë shumë e cila mbartet në periudhat e ardhshme për shkak të volumit të çështjeve dhe faturave që dorëzohen në Prokurorinë e Tiranës.

• **Prokuroria Rrethit Berat**

Nga auditimi i pasqyrës së “Cash Flow” rezultoi se:

- Të hyra nga Mjetet ne ruajtje(+) janë në shumën prej 409,600 lekë

- Pagesat per mjetet ne ruajtje(-) janë në shumën -300,600 lekë

Diferenca 109,000 lekë

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” është rritur nga viti 2021 në shumë prej 83,000 lekë dhe jo në shumën prej 109,000 lekë, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrës së “Pozicionit financiar”.

Diferenca prej 26,000 lekë është pasqyruar si rritje në llogarinë e 532 "Vlera të tjera", të cilat janë mjete që ruhen në arkë në formën e pullave tatimore.

Sa më sipër kemi një mospërputhje të llogarive të pasqyrës së pozicionit financiar me shumata e pasqyruara në cash flow, por pa ndikim material në paraqitjen e pasqyrave financiare.

- **Prokuroria Rrethit Dibër**

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar rezultoi se nga institucioni është berë debitimi i llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" në vlerën 390,000 lekë dhe është kredituar kjo shume në llogarinë 467 "*Kreditore të ndryshëm*".

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pasi nëse janë detyrime ndaj palëve të treta për blerje mallra/shërbime/punë, shuma prej 390,000 lekë, duhet të ishte debituar në llogarinë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*". Vlera prej 390,000 lekë nga analiza e shpenzimeve buxhetore të vitit 2022 rezulton se janë detyrime ndaj furnitorëve.

Sa më sipër kemi një keqklasifikim të llogarive, pa ndikim material në paraqitjen e pasqyrave financiare.

- **Prokuroria Rrethit Gjirokastrë**

Në pasqyrën 7/b "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)*" rezultoi se për pakësimet e aktiveve në llogarinë 218 "*Inventar ekonomik*" në vlerën 166,944 lekë, nga institucioni nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.

- **Prokuroria Rrethit Kavajë**

Nga auditimi i pasqyrës së "Cash Flow" rezultoi se:

- Të hyra nga Mjetet ne ruajtje(+) janë në shumën prej 67,000 lekë

- Pagesat per mjetet ne ruajtje(-) janë në shumën 0 lekë

Diferenca 67,000 lekë

Llogaria 466 "*Kreditore për mjete në ruajtje*" është rritur nga viti 2021 në shumë prej 99,400 lekë dhe jo në shumën prej 67,000 lekë, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrës së "*Pozicionit financiar*".

Diferenca prej 32,400 lekë, nuk duhet të ishte pasqyruar në llogarinë 466 por si rritje të llogarisë 532 "Vlera të tjera", të cilat janë mjete që ruhen në arkë në formën e pullave tatimore, pasi në cash flow shuma e arkëtuar "Të tjera, arkëtuar(+)" janë në shumën prej 216,000 lekë, nga të cilët "Lëvizje të brendshme e transfertat të tjera(+)" janë në shumën prej 111,600 lekë pra një diferencë në rritje në shumën prej 104,400 lekë, e cila duhet të ishte pasqyruar si ndryshim i llogarisë 532 "Vlera të tjera" nga viti 2021 në vitin 2022.

Pra sa më sipër kemi një mospërputhje të llogarive të pasqyrës së pozicionit financiar me shumata e pasqyruara në "cash flow", por pa ndikim material në paraqitjen e pasqyrave financiare.

- **Prokuroria Rrethit Lushnje**

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar rezultoi se nga institucioni është berë debitimi i llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" në vlerën 404,901 lekë dhe është kredituar kjo shume në llogarinë 467 "*Kreditore të ndryshëm*".

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pasi nëse janë detyrime ndaj palëve të treta për blerje mallra/shërbime/punë, shuma prej 404,901 lekë duhet të ishte debituar në llogarinë 486

“Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Vlera prej 404,901 lekë nga analiza e shpenzimeve buxhetore të vitit 2022 rezulton se janë detyrime ndaj furnitorëve.

Pra sa më sipër kemi një keqklasifikim të llogarive, pa ndikim material në paraqitjen e pasqyrave financiare.

*Nga auditimi i pasqyrës së “Cash Flow” rezultoi se:*

- Të hyra nga Mjetet ne ruajtje(+) janë në shumën prej 13,115,620 lekë

- Pagesat per mjetet nw ruajtje (-) janë në shumën -378,720 lekë

Diferenca 12,736,900 lekë

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” është rritur nga viti 2021 në shumë prej 13,078,100 lekë dhe jo në shumën prej 12,736,900 lekë, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrës së “Pozicionit financiar”.

Nga analiza e llogarive të pasqyrës së pozicionit financiar rezultoi se llogaria 532 “Vlera të tjera” është zvogëluar në shumën prej 341,200 lekë, ku në pasqyrën e “cash flow” nuk është pasqyruar ky ndryshim në zërin “Lëvizje e brendshme e transferata te tjera(+/-)”.

*Mos pasqyrimi dhe kontabilizimi i shumave në llogaritë përkatëse jep efekt në pasqyrimin e jo të drejtë të pasqyrave financiare, me ndikim material.*

- **Prokuroria Rrethit Pogradec**

Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” rezultoi se për pakësimet e aktiveve të nxjerrë jashtë në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,367,576 lekë, nga institucioni është llogaritur amortizimi i akumuluar në shumën prej 18,385 lekë, një vlerë e cila nuk përputhet me kushtet e nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve.

Sa më sipër nga institucioni nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.

- **Prokuroria Rrethit Shkodër**

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar rezultoi se nga institucioni është bërë debitimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 929,849 lekë dhe është kredituar kjo shume në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm”.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pasi nëse janë detyrime ndaj palëve të treta për blerje mallra/shërbime/punë, shuma prej 929,849 lekë duhet të ishte d në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”. Vlera prej 929,849 lekë nga analiza e shpenzimeve buxhetore të vitit 2022 rezulton se janë detyrime ndaj furnitorëve, ku vlera prej 361,948 lekë të krijuara nga 2022 dhe diferenca e trashëguar nga viti paraardhës.

Pra sa më sipër kemi një keqklasifikim të llogarive, pa ndikim material në paraqitjen e pasqyrave financiare.

Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare, në llogarinë “Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemi” është pasqyruara vlerën 10,800 lekë, vlerë e cila nuk ka gjurmë në pasqyrën cash flow dhe pasqyrën e pozicionit financiar.

Sa më sipër të gjithë konstatimet në pasqyrat financiare individuale të institucioneve kanë ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara të institucionit, me ndikim material.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Pasqyrat financiare të konsoliduara.
---------------------------	--------------------------------------

<b>Situata:</b>	<p>- Nga auditimin i të dhënave të pasqyrës 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” në pasqyrat financiare të konsoliduara rezultoi se për pakësimet e aktiveve në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, nga njësitë nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.</p> <p>- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të konsoliduar rezultoi se është bërë debitimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 1,724,750 lekë , vlerë e cila është kredituar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm”. Nga analiza e shpenzimeve buxhetore të vitit 2022 rezulton se kjo shumë është detyrim ndaj palëve të treta për blerje mallra/shërbime/punë, vlerë e cila duhet të ishte debituar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.</p> <p>- Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës “Cash Flow” dhe pasqyrimi i ndryshimit të llogarive në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi mosrakordim të shumave të arkëtuara për llogarinë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” dhe llogarinë 532 "Vlera të tjera”, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrës së “Pozicionit financiar”, por pa ndikim material.</p> <p>Sa më veprim në kundërshtim me Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar paragrafi 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1”; 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, si dhe “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mospasqyrimi i saktë i zërave në pasqyrat financiare të institucionit, sjell risku që, Pasqyrat financiare të konsoliduara nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, në regjistrat kontabël.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kërkesave të UMFE nr.8, date 09.03.2018, i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria Ekonomike dhe Financës të marrë masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korrigjimin e sistemimit të tyre në pasqyrat financiare të viteve pasardhëse.

**c) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël**

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Prokuroria e Përgjithshme ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m<sup>2</sup>, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2022-2023. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit, sipas parashikuar në Paragrafi nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me Fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

### ***Më konkretisht:***

#### **Për vitin 2022:**

##### *a) Inventarizimi fizik dhe Vlerësimi i aktiveve*

Në urdhrin e Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 121, datë 04.11.2022 “Mbi inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e tyre” është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit, ku në pikën 2 të urdhrin citohet se afati i kryerjes së inventarizimit është nga data 10.11.2022 deri me datën 15.12.2022.

#### **Konstatim:**

Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal me datën 15.12.2022, ku është fiksuar numri rendor i Fletë hyrjes dhe Fletë daljes nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, ditën kur është mbyllur inventarizimi fizik i aktiveve, veprime në kundërshtim me përcaktimit e paragrafit 83, të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar, ku citon “Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i Fletë hyrjes dhe Fletë daljeve nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe behet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja behet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material” nga dosja e inventarizimit konstatohet se nga komisioni është mbajtur procesverbal për fiksimin e Fletë dalje dhe hyrje”.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa më sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011.

Në dosje janë depozituar kartelat/ Fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Në fund të procesit të inventarizimit, nga komisioni është përgatitur informacion përmbledhës mbi inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2022, në të cilën citohet se:

- U përpilua një procesverbal për fiksimin e numrit rendor i Fletë hyrjes dhe Fletë daljes nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit.
- U krye verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve në përdorim të institucionit dhe

magazinës.

- Në bashkëpunim me drejtorinë e financës u krahasua gjendja konkrete e aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit, ku nuk u konstatuan diferenca.
- U përpilua një procesverbal me listën e materialeve që kanë humbur vlerën dhe janë vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimi, në një listë prej 75 artikuj dhe vlerë kontabël 9,137,662.9 lekë.
- U përpilua një procesverbal me tepricë të gjetur, për tu bërë hyrje në magazinë.

Nga komisioni është mbajtur procesverbali me nr 1667/1 datë 15.12.2022 “Për vlerësimin e Aktiveve Materiale”, ku citon se mbasi është bërë kontrolli dhe vlerësimi material i aktiveve ka propozuar nxjerrjen jashtë përdorimi të aktivet si: Kompjutera, Laptop, UPS, Telefon fax, Server, Printera, Grirëse, Pajisje Elektronike, Skaner, Fotokopje, Kondicioner, si dhe pajisje të tjera në total 75 artikuj me vlerë kontabël 9,137,662.9 lekë, ku janë përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlera e mbetur të tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime sipas përcaktimeve të paragrafit 102-105 të UMF me nr. 30/2011, i ndryshuar.

### **Konstatim:**

Nga auditimi u konstatua se institucioni pas procesit të vlerësimit ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivet e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën prej 9,137,662.9 lekë. Nga PP këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, si dhe Udhëzimit me nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109. Aktivet kalojnë në llogarinë 24 “Aktive të Qend.te trupëzuara te dëmtuara” pasi ato janë vlerësuar për jashtë përdorimi dhe deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre mbahen nga institucioni duke bërë daljen nga Inventari i institucionit dhe mbajtjen e tyre në magazinë me një Fletë hyrje rikupero.

#### *b) Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve*

Me Urdhrin e NA nr. 43, datë 23.06.2022 është ngritur komisioni “Për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi” e përbërë nga 7 anëtarë, e cila ka përbërje tjetër nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, sipas përcaktimit të parashikuar paragrafit 97, të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve ka një vlerë fillestare prej 215,496,585 lekë, të vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi nga komisioni “Mbi inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e tyre” i ngritur me urdhrin nr. 78 datë 01.11.2021, ku është hartuar dhe procesverbali me nr. 1680/1, datë 06.12.2021.

Në pikën 3 të Urdhrin e NA nr. 43, datë 23.06.2022 është cituar se nga vlera totale e aktiveve të propozuara nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimi, aktivi me emërimin “Shtesë kati me konstruksione metalike të kombinuar” me vlerën 5,540,708 lekë, fizikisht ka kaluar pa pagesë me Urdhrin me nr. 5, datë 14.01.2022, dhënë për skrap Drejtorisë së përgjithshme të Rezervave të Shtetit.

Në vijim të kësaj komisioni i asgjësimit të aktiveve të asgjësojë sasinë e mbetur të aktiveve, e përbërë prej 7 artikuj në vlerën 209,955,877 lekë. Procesi fillon me datën 24.06.2022 dhe përfundon me datën 15.07.2022.

Nga Komisioni është mbajtur procesverbali me nr. 987, datë 15.07.2022, ku është relatuar procesi i asgjësimit.

- Me Urdhrin e NA nr. 74, datë 24.06.2022 është ngritur komisioni “Për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi” të AAM dhe 4 artikuj të inventar i Imët.

Në urdhër citohet se numri i artikujve për asgjësim është 174 në vlerën prej 34,970,530.27 lekë. Procesi fillon me datën 24.06.2022 dhe përfundon me datën 15.07.2022.

Nga Komisioni është mbajtur procesverbali me nr. 987/1, datë 15.07.2022, ku është relatuar procesi i asgjësimit.

Në procesverbal nga komisioni është argumentuar se:

- Për tre artikuj “Orendi zyre” në vlerën 136,282 lekë komisioni ka propozuar kthimin e tyre ne magazinë dhe sipas kërkesave dhe nevojave të transferohen brenda institucioneve të varësisë.

- Për artikullin nr. A0168 “APC Netsheld” në vlerë 110,00 lekë, ka propozuar kthimin e tij ne inventarin e institucionit edhe pse nuk ka funksion primar, por ka informacion CAMS, e cila në çdo moment shërbejnë për Back Up.

- Për artikujt A10588; A0215 dhe A0789 në vlerë totale 314,617,41 lekë komisioni vendosi se duke qenë se janë metalike të mos asgjësohen, por ti kalojnë për skrap Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit.

- Për artikullin A0065 “Sistemi i kamerave” shprehet se një pjesë është për asgjësim në vlerën 1,507,134 lekë dhe një pjesë është për rikuperim në vlerën 881,664 lekë, të cilat janë bërë hyrje me Fletë hyrjen me nr. 2, datë 15.07.2022.

- Rrjetin elektrik, nga komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimi në procesverbalin e mbajtur është cituar se, nga vlerësimi për dalje jashtë përdorimi të vlerës 13,795,031 lekë, nga kjo shumë të rikthehen në gjendje pune vlera 1,745,279 lekë “*Punime për gabinen e vendrojtës dhe ambiente Zyre*”, e cila është bërë hyrje me Fletë hyrjen me nr. 4, datë 15.07.2022, si dhe i vlerës 1,684,440 lekë “*Punime instalime të kamerave*”, bërë hyrje me Fletë hyrjen nr. 3 datë 15.07.2022.

Procesi i asgjësimit është bërë sipas përcaktimit të parashikuar në paragrafin 109, Kreu IV të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Nga magazina janë bërë dalje me Fletë daljen nr. 16, datë 15.07.2022.

- Aktivet e vlerësuar për jashtë përdorimi janë asgjësuar, ku procesi i asgjësimit është dokumentuar në proces verbalin me nr. 987/1, datë 15.07.2022 të komisionit të shoqëruar me pamje fotografike dhe dokumentacionin e depozitimit.

### **Viti 2023**

- Me Urdhrin e NA nr. 47, datë 14.04.2023 është ngritur komisioni “*Për asgjësimin e aktiveve të vlerësuar për jashtë përdorimi*” e përbërë nga 7 anëtarë, e cila ka përbërje tjetër nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, sipas përcaktimit të parashikuar paragrafit 97, të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Nxjerrja jashtë përdorimi të aktiveve pajisje dhe materiale ka një vlerë fillestare prej 9,137,662.9 lekë, bazuar në procesverbalin me nr 1667/1 datë 15.12.2022 “*Për vlerësimin e Aktiveve Materiale*” të mbajtur nga komisioni i ngritur me urdhrin me nr. 121, datë 04.11.2022 “*Mbi inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e tyre*”.

Procesi i asgjësimit është bërë sipas përcaktimit të parashikuar në paragrafin 109, Kreu IV të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar. Nga magazina janë bërë dalje me Fletë daljen nr. 12, datë 14.04.2023.

- Aktivet e vlerësuar për jashtë përdorimi janë asgjësuar, ku procesi i asgjësimit është dokumentuar në proces verbalin me nr. 782, datë 14.05.2023 të komisionit të shoqëruar me pamje fotografike dhe dokumentacionin e depozitimit.

## **2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.**

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim;

- Transaksionet e llogarive bankare;

- Paga për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, bazuar në ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”. “*ISA 530 zbatohet kur audituesi ka vendosur të përdorë kampionimin e auditimit në kryerjen e*

*procedurave të auditimit. Ai merret me përdorimin nga audituesi të kampionimit statistikor dhe jostatistikor gjatë hartimit dhe përzgjedhjes së kampionit të auditimit, kryerjen e testeve të kontroleve dhe testet e detajeve, dhe vlerësimin e rezultateve nga ky kampion, cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen”, mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit të realizuara në Prokurorinë e Përgjithshme, veprimet e kryera me bankën konstatohet se, janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritetet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.”*

***a) Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë:***

Veprimet e arkës në valutë në institucion dokumentohen nëpërmjet mandat-arkëtimeve dhe mandat-pagesave të cilat nënshkruhen nga arkëtari, nga financieri dhe marrësi i paradhënies. Regjistrimet e veprimeve të arkës janë kryer në llogari kontabile të arkës, nga Sektori i Financës dhe në librin e arkës nga ana e punonjësit të caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare. Dokumentet e arkës janë shqyrtuar, kontrolluar dhe nënshkruar nga personat e poshtëshënuar: mandatarkëtimet nënshkruhen rregullisht nga personi përgjegjës për vlerat monetare dhe nga Nëpunësi Zbatues; mandatpagesat nënshkruhen nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga zyrtari që ka nënshkruar mandatpagesën (marrësi) dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare. Përgjithësisht nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të arkës në valutë konstatohet se, institucion respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar të MFE, dhe sa më sipër është mbajtur libër arke ku janë regjistruar rregullisht mandat arkëtimet e pagesat dhe janë bërë mbylljet e tij rregullisht çdo muaj, në zbatim të parashikimeve të paragrafit nr.67 dhe 68 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, që ka përcaktuar se:

- 67. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga sektori i financës dhe libër arke nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare.*
- 68. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat e poshtëshënuar:*
- a. mandatarkëtimi nënshkruhet nga personi përgjegjës për vlerat monetare, nga punonjësi që kryen derdhjen dhe nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij;*
  - b. mandatpagesa nënshkruhet nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga marrësi i parave dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare.*
  - c. Nëpunësi Autorizues ose i deleguari i tij, nënshkruan mandatpagesën kur nuk ka një dokument tjetër urdhëruar të nënshkruar prej tij.*

Nga auditimi rezultoi se regjistrimet kontabile në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, të kuadruara dhe duke u bazuar në dokumentacionin justifikues përkatës. Nga auditimi rezulton se, nëpërmjet arkës në valutë janë kryer kryesisht pagesa për shërbime udhëtimi e dieta jashtë vendit. Në të gjitha rastet e audituara, paradhënia ka rezultuar të jetë sistemuar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, menjëherë pas paraqitjes së dokumenteve justifikuese, për shpenzimet e kryera, nga ana e nëpunësit udhëtues, e shoqëruar kjo sipas rastit me Mandat Pagesën ose Mandatin e Arkëtimet. Nga testimet e kryera nuk rezultoi të jetë akorduar paradhënie e dytë pa shlyer paradhënien e parë. Transaksionet financiare, në formën e paradhënies, për udhëtime e dieta,



rezultojnë të kryera në zbatim të VKM nr. 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Çdo veprim në arkë është kryer vetëm me Urdhër të Titullarit të Institucionit (Sekretari i Përgjithshëm). Nga auditimi rezulton se, arka është inventarizuar periodikisht çdo muaj duke mos rezultuar me diferenca. Në fund të vitit arka është mbyllur me gjendje zero.

U shqyrtua libri i arkës në valutë për disa transaksione të përzgjedhura nga grupi i auditimit bazuar në vlerat më të larta.

Praktikat për likuidimet e kryera për shërbimet jashtë vendit janë hartuar nga personat udhëtues së bashku me dokumentacionin vërtetues përkatës.

Nga auditimi i praktikave të përzgjedhura rezultoi se bashkëlidhur praktikës nuk është *autorizimi i titullarit të institucionit për personat të cilët do të marrin pjesë në takime si përfaqësues të PP, sic e përcakton Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”*, pika 5, ku citohet se: *Në përfundim të shërbimit, punonjësi dorëzon te firmosur pranë zyrës së financës së njësisë, Urdhër-shërbimin duke i bashkëngjitur atij autorizimin e titullarit të institucionit qendror, ose te deleguarit të tij, dhe te gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit.*

#### **b) Auditimi i transaksioneve të kryera me bankën:**

U auditua me zgjedhje dokumentacioni mbështetës i veprimeve dhe transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimit. U konstatua se urdhër shpenzimet në përgjithësi kishin bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, të cilat janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakordura nga dega e thesarit.

*Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve rezultoi se:*

- Me urdhër shpenzimin nr. 354, datë 27.12.2022 është likuiduar OE/T. L., bazuar në kontratën e lidhur me nr. 1633/4, datë 22.12.2022 “Për blerje set tavoline për sallën e mbledhjes me karrige” dhe faturën nr. 166, datë 22.12.2022.

Nga OE është lëvruar malli po më datën 22.12.2022, në ditën e lidhjes së kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratës me 1633/4, datë 22.12.2022 në vlerën 1,254,000 lekë me TVSH me afat përfundimi 7 dite nga lidhja e kontratës, **rezultoi se:**

Nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Përbushjes së Detyrimeve të Kontratës krijuar me urdhrin e NA me nr. 128/3, datë 22.12.2022 është mbajtur procesverbali i kontrollit të mallrave me datë 23.12.2022, ku citojnë se mallrat janë lëvruar në përputhje me sasinë e specifikuar në kontratë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Malli i lëvruar është bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 14, datë 22.12.2022.

- Me urdhër shpenzimin nr. 353, datë 27.12.2022 është likuiduar OE/D. A., bazuar në kontratën e lidhur me nr. 1633/2, datë 22.12.2022 “Për blerje karrige zyre copë 104” dhe faturën nr. 945, datë 22.12.2022.

Nga OE është lëvruar malli po më datën 22.12.2022, në ditën e lidhjes së kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratës me 1633/2, datë 22.12.2022 në vlerën 4,140,864 lekë me TVSH me afat përfundimi 2 dite nga lidhja e kontratës, **rezultoi se:**

Nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Përbushjes së Detyrimeve të Kontratës krijuar me urdhrin e NA me nr. 128/2, datë 22.12.2022, është mbajtur procesverbali i kontrollit të mallrave me datë 23.12.2022, ku citojnë se mallrat janë lëvruar në përputhje me sasinë e specifikuar në kontratë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Malli i lëvruar është bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 15, datë 22.12.2022.

**Sa më sipër konstatohet** se magazinimi i mallrave me fletë-hyrje është bërë më përpara se komisioni të bëjë verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37 “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë”.

- Me urdhër shpenzimit nr. 239, datë 20.09.2022, në vlerën 2,984,128 lekë është likuiduar U.P.T. bazuar në kontratën shërbimit të lidhur me nr. 833/5, datë 01.08.2022 “Kontratë shërbimi” për Rikonstruksionin e godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se bashkëngjitur urdhër shpenzimit është vetëm kontrata e lidhur mes dy palëve, fatura tatimore e lëshuar nga U.P.T. me nr. 244/2019, datë 13.09.2022.

Bashkëlidhur dokumentacionit mungon **projekti i finalizuar nga U.**, i cili është përlllogaritur:

- Projektimi faza I-VI në vlerën 2,177,691 lekë;
- Shërbimi i nëntokës në vlerën 343,656;
- Shërbimi topografisë në vlerën 226,909;
- Shërbimi i auditimit të energjisë në vlerën 235,872 lekë.

Bashkëlidhur nuk ka një komision të ngritur nga PP për marrjen në dorëzim të këtij projekti dhe për realizimin e kontratës.

- Me urdhër shpenzimit nr. 115, datë 13.04.2023, në vlerën 400,000 lekë është likuiduar I. N., bazuar në akt marrëveshjen (me prot., të PP nr. 190/1, datë 27.01.2023), për realizimin e akt ekspertizës së godinës së Prokurorisë së Rrethit Kavajë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit rezultoi se likuidimi është bërë bazuar në faturën tatimore me nr. 279/2023, datë 05.04.2023, ku mungon akt ekspertiza e realizuar nga I. dokument vërtetues për realizimin e shërbimit nga ana e tij dhe procesverbali i mbajtur nga komisioni nëse është ngritur nga PP, për mbikëqyrjen e përmbushjes së kontratës.

- Me urdhër shpenzimit nr. 216, datë 28.07.2023, në vlerën 400,000 lekë është likuiduar I. N., bazuar në akt marrëveshjen (me prot., të PP nr. 573/2, datë 04.05.2023), për realizimin e akt ekspertizës së godinës së Prokurorisë së Rrethit Dibër.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit rezultoi se likuidimi është bërë bazuar në faturën tatimore me nr. 510/2023, datë 06.07.2023, ku mungon akt ekspertiza e realizuar nga I. si dokument vërtetues për realizimin e shërbimit nga ana e tij

Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është procesverbali i mbajtur nga z. A.B., ku citon se realizimi i oponencës është bërë në respektim të afatit të përcaktuar në aktmarrëveshje dhe në çmimin e përcaktuar në të.

- Me urdhër shpenzimit nr. 205, datë 28.07.2023, në vlerën 1,686,898 lekë është likuiduar I. N., bazuar në akt marrëveshjen (me prot., të PP nr. 573/1, datë 04.05.2023), për hartimin e projektit “Shtesë godine të Prokurorisë së Rrethit Dibër”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimit rezultoi se likuidimi është bërë bazuar në faturën tatimore me nr. 509/2023, datë 06.07.2023, ku mungon projekti i hartuar nga Instituti si dokument vërtetues për realizimin e shërbimit nga ana e tij

Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është procesverbali i mbajtur nga z. A.B. në datën 06.07.2023, ku citon shërbimi është realizuar në respektim të afatit të përcaktuar në aktmarrëveshje dhe në çmimin e përcaktuar në të.

Në nenin 3 të akt marrëveshjen është cituar se porositësi do të shqyrtojë projektin brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit dhe do të japë vlerësimet e saj. Nga PP nuk ka asnjë dokument që sqaron cilësinë e projektit të dorëzuar.

- Me urdhër shpenzimin nr. 255, datë 15.09.2023, në vlerën 400,000 lekë është likuiduar I. N., bazuar në akt marrëveshjen (me prot., të PP nr. 876/1, datë 22.05.2023), për realizimin e akt ekspertizës së godinës së Prokurorisë së Rrethit Korçë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shërbimit rezultoi se likuidimi është bërë bazuar në faturën tatimore me nr. 553/2023, datë 26.07.2023, **ku mungon relacioni i shërbimit të realizuar** nga I. si dokument vërtetues për realizimin e shërbimit nga ana e tij

Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është procesverbali i mbajtur me datë 26.07.2023 nga z. A.B., ku citon se realizimi i oponencës është bërë në respektim të afatit të përcaktuar në aktmarrëveshje dhe në çmimin e përcaktuar në të.

- Me urdhër shpenzimin nr. 211, datë 28.07.2023, në vlerën 400,000 lekë është likuiduar U.P.T. bazuar në akt marrëveshjen (me prot., të PP nr. 1614/1, datë 14.07.2023), për realizimin e oponencës teknike, në lidhje me “Shtim kati në godinën e Prokurorisë së Rrethit Dibër”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shërbimit rezultoi se likuidimi është bërë bazuar në faturën tatimore me nr. 198/2023, datë 17.07.2023, **ku mungon relacioni i shërbimit të realizuar nga U.P.T.** Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është procesverbali i mbajtur nga z. A.B., ku citon se realizimi i oponencës është bërë në respektim të afatit të përcaktuar në aktmarrëveshje dhe në çmimin e përcaktuar në të.

**Për të gjithë urdhër shpenzimet sa më sipër**, mungesa e dokumentacionit bashkëlidhur dhe likuidimi i OE në mungesë të tyre janë veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” **nenin 4, pika 26**, “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkaktun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin që rregullon dokumentin elektronik”; neni 12, pika 3, germa dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; **Nenin 4, pika 19** “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”.

- Me urdhër shpenzimin nr. 270, datë 19.09.2023 është likuiduar B. E., bazuar në kontratën e lidhur me nr. 986/23, datë 24.07.2023 “Për blerje fotokopje” dhe faturën nr. 7296, datë 31.08.2023, në vlerën 1,305,000 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratës me nr. 986/23, datë 24.07.2023 në vlerën 1,305,000 lekë me TVSH me afat përfundimi 2 dite nga lidhja e kontratës, **rezultoi se:**

Nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Përbushjes së Detyrimeve të Kontratës krijuar me urdhrin e NA me nr. 48/7, datë 30.08.2023, është mbajtur procesverbali i kontrollit të mallrave me datë 07.09.2023, ku citojnë se mallrat janë lëvruar në përputhje me sasinë e specifikuar në kontratë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kontratës. Malli i lëvruar është bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 4, datë 06.09.2023.

**Sa më sipër konstatohet** se magazinimi i mallrave me fletë-hyrje është bërë më përpara se komisioni të bëjë verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37 “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes ne dorëzim te aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë”.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Magazinimi i mallrave përpara verifikimit fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit të tyre.
<b>Situata:</b>	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratave për “Për blerje set tavoline për sallën e mbledhjes me karrige”; “Për blerje karrige zyre copë 104” dhe “Për blerje fotokopje” rezultoi se: Magazinimi i mallrave me fletë-hyrje është bërë më përpara se komisioni të bëjë verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37 “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes ne dorëzim te aktiveve, referuar kushteve te përcaktuara ne kontrate”.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risku i marrjes së mallrave në dorëzim të cilat mund të mos plotësojnë kriteret specifike te parashikuar në kontrate.
<b>Shkaku:</b>	Magazinimi i mallrave përpara verifikimit fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit të tyre.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat në vazhdimësi, që mallrat shërbimet të merren në dorëzim nga OE, pas verifikimit fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit, referuar kushteve te përcaktuara ne kontratë.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Mungesa e dokumentacionit bashkëlidhur urdhër shpenzimeve.
<b>Situata:</b>	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratave për: - “Kontratë shërbimi” projektin për rikonstruksionin e godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës. - Akt ekspertizës së godinës së Prokurorisë së Rrethit Kavajë. - Akt ekspertizës së godinës së Prokurorisë së Rrethit Dibër. - Për hartimin e projektit “Shtesë godine të Prokurorisë së Rrethit Dibër”. - Akt ekspertizës së godinës së Prokurorisë së Rrethit Korçë. - Realizimin e oponencës teknike, në lidhje me “Shtim kati në godinën e Prokurorisë së Rrethit Dibër” u konstatua se: Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është vetëm kontrata e lidhur mes dy palëve dhe fatura tatimore e lëshuar nga OE dhe mungon dokumentacioni vërtetues për realizimin e shërbimit si: Projektet e realizuara, akt ekspertiza dhe oponencat teknike.
<b>Kriteri:</b>	Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” <b>nenin 4, pika 26</b> , “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo

	<i>të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin që rregullon dokumentin elektronik”; neni 12, pika 3, germa dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; <b>Nenin 4, pika 19</b> “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve”, si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”.</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos gjurmimi i transaksionit financiar.
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajtja e dokumentacionit të plotë bashkëlidhur Urdhër shpenzimeve nga Drejtoria e Financës.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat, që në të gjithë urdhër shpenzimet të ketë të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues të realizimit të shërbimit, me qëllim garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi.

**c) Auditimi i procedurave të prokurimit “Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar” si dhe shpenzimet për trajtimin financiar të punonjësve.**

Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave të përbërë prej 3 anëtarësh, bazuar në Udhëzimin e APP nr. 3, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”.

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve u konstatua se:

Në të gjithë urdhër shpenzimet mungonte autorizimi për pjesëmarrje nga titullari i Prokurorisë së Përgjithshme, veprime këto në kundërshtim me VKM-në me nr. 870, date 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” pika 3, si dhe Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, date 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” pika 2 ku citon se: “E drejta për të përcaktuar nivelin e përfaqësimit të institucionit (nivel drejtues i lartë, i mesëm ose nivel specialisti) në këto aktivitete jashtë vendit, si dhe numrin e nëpunësve/punonjësve pjesëmarrës, është e titullarit të institucionit qendror nga i cili varet njesia shpenzuese”.

Bashkëlidhur janë vetëm urdhrat e NA drejtuar sektorit të financës dhe buxhetit për mbulimin e shpenzimeve ndaj delegacioneve.

Ndërsa në:

- Urdhër shpenzimin nr. 56, datë 03.03.2022 në vlerën 90,700 lekë, ku është likuiduar OE/ A.T. & T.;
- Urdhër shpenzimin nr. 99, datë 27.04.2022 në vlerën 48,698 lekë, ku është likuiduar OE/ S.T.& T.;
- Urdhër shpenzimin nr. 133, datë 23.05.2022 në vlerën 120,500 lekë, ku është likuiduar OE/B. A.;

- Urdhër shpenzimin nr. 289, datë 02.11.2022 në vlerën 146,202 lekë, ku është likuiduar OE/ K.T. SHPK.

**Nga dokumentacioni bashkëlidhur urdhrat konstatohet se:**

- Mungon autorizimi për pjesëmarrje nga titullari i PP.
- Mungon urdhri drejtuar Sektorit të financës dhe buxhetit për mbulimin e shpenzimeve.
- Mungojnë biletat e sjella nga OE për personat udhëtues.
- Urdhër shpenzimin nr. 156, datë 14.06.2022 në vlerën 126,324 lekë, ku është likuiduar OE/ K.T. SHPK.

**Nga dokumentacioni bashkëlidhur urdhrat konstatohet se:**

- Mungon autorizimi për pjesëmarrje nga titullari i PP.
- Mungon urdhri drejtuar Sektorit të financës dhe buxhetit për mbulimin e shpenzimeve

Sa më sipër, në të gjithë urdhër shpenzimet mungon komisioni i marrjes në dorëzim të biletave, për të vërtetuar nëse shërbimi i blerë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në “Ftesën për ofertë”.

- Në të gjithë urdhër-shpenzimet e blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve të likuiduara nëpërmjet arkës, të përzgjedhura për t’u audituar nga grupi i auditimit, u konstatua mungesa e ftesës së vendit pritës, si dhe programi i aktivitetit në të cilën përfaqësuesit kanë marrë pjesë.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me nenin 4, pika 26 të Ligjit nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ku citohet se “Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

<b>Titulli i Gjetjes:</b>	Auditimi i likuidimit të dhjetë urdhër shpenzime për shërbime-dieta jashtë vendit të punonjësve.
<b>Situata:</b>	Në të gjithë urdhër shpenzimet e përzgjedhura për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, nga ana e Grupit i Auditimit u konstatua se: - Në të gjithë urdhër shpenzimet mungonte autorizimi për pjesëmarrje nga titullari i Prokurorisë së Përgjithshme. Bashkëlidhur janë vetëm urdhrat e NA drejtuar sektorit të financës dhe buxhetit për mbulimin e shpenzimeve ndaj delegacioneve. - Mungesa e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve. Me anë të këtyre dokumenteve, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit. - Në të gjithë urdhër shpenzimet mungon komisioni i marrjes në dorëzim të biletave, për të vërtetuar nëse shërbimi i blerë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në “Ftesën për ofertë”.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimin nr.22 të MFE, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me

	<i>shërbim jashtë vendit</i> ”, pika 4 dhe me Ligjin nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 “ <i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i> ” i ndryshuar, nenin 4, pika 26, ku citohet se: “ <i>Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkaktun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative</i> ”, nenin 4, pika 19 “ <i>Gjurma e auditimit</i> ”, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “ <i>Dokumente vërtetues</i> ”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik</i> ”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos dokumentimi i gjurmëve të auditimit.
<b>Shkaku:</b>	Mosmbajtja e dokumentacionit të plotë bashkëlidhur të transaksioneve financiare.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	- Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa që në të gjitha praktikat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave t’i bashkëngjitet, autorizimi për pjesëmarrje nga titullari i institucionit, ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve, si dhe procesverbali nga komisioni i marrjes në dorëzim të biletave, për të vërtetuar nëse shërbimi i blerë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në “ <i>Ftesën për ofertë</i> ”.

#### IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

##### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të kontabilizuar në llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*”, u konstatua se në këtë llogari është debituar vlera prej 467,436 lekë e llogarisë 401 “*Furnitorë e llogari te lidhura me to*”. Këto detyrime janë të trashëguara, që përpara vitit 2010, të cilat kanë humbur statusin e detyrimeve afatshkurtra. Llogaria 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” përfaqëson burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor), që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës.

Sa më sipër vlera prej 467,436 lekë e debituar në llogarinë 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, paragrafi 3.2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa për sistemimin e shumës prej 467,436 lekë, duke e kryer veprimin kontabël, debitimin e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura*” dhe kreditimin e llogarisë përkatëse 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”.

Afati: **Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 3,803,861 lekë, shifër kjo e njëjtë me atë të një viti më parë, pasi janë debitorë të trashëguar që prej vitit 2002.

- Nga ana Institucionit *për debitorët ish-punonjës* nuk është proceduar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, si rrjedhojë ky detyrim është i paarkëtushëm, pasi ka humbur fuqinë ligjore, bazuar në nenin 203, pika 1, të Kodit të Punës ku përcaktohet se “Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet”, si dhe nenin 115/dh të Kodit Civil, që nënvizon se “Parashkruhen brenda afateve prej: tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë”.

- Në lidhje me *detyrimet ndaj personave fizike dhe subjekteve juridike*, të krijuar para vitit 2002 bazuar në Kodin Civil, neni 114 “Afatet e parashkrimit” është përcaktuar se: “Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë” dhe neni 121 “Për kthimin e shumës së parave ose të sendit që është fituar ose kursyer pa shkak, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për fitimin ose kursimin pa shkak që ka realizuar personi përkatës”, e për rrjedhojë këto detyrime janë parashkruar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat për sistemimin e këtyre vlerave, të cilat janë të parashkuara dhe të paarkëtueshme, me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

*Afati: Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një institucion i varësisë në një tjetër, në disa praktika u konstatua se, procedura e kalimit nuk ka të bashkëlidhura urdhrin e miratimit për kalim kapitali, autorizimin e tërheqjes së aktivitetit, procesverbalin e marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga institucioni që ka bërë kalim kapitali, deri në momentin e daljes nga pronësia, ku vlera e këtyre aktiveve të transferuara janë regjistruar me vlerën historike nga institucionet përfituese, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës reale të aktiveve neto.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalëse, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

*Afati: Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të pasqyrës së aktivitetit dhe regjistrit për vitin 2022 u konstatua se:

- Një pjesë e “pajisjeve elektronike” janë klasifikuar në llogarinë 2187 “Të tjera pajisje zyre” dhe jo në llogarinë 218600 “pajisje elektronike”, ku amortizimi në vite është llogaritur me normën 20 % dhe jo 25%, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Klasa 2 “Aktive afatgjata” dhe pika 36 “Në lidhje me



amortizimin e aktiveve afatgjata”, me ndikim në vlerën neto të aktiveve dhe fondeve neto të institucionit.

- Një pjesë e “Pajisjeve dhe instalimi i kondicionerëve” janë klasifikuar në llogarinë 218700 “Inventar ekonomik”, ku kjo vlerë i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”, por pa ndikim në vlerën neto të aktiveve pasi normat e amortizimit është 20% për të dy klasifikimet.

- Nga auditimi u konstatua se institucioni pas procesit të vlerësimit ka vlerësuar për jashtë përdorimi aktivet e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën prej 9,137,662.9 lekë, ku në pasqyrat financiare të mbyllura për vitin 2022, këto vlera janë lënë ende tek zërat e aktiveve gjendje pune. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit me nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Paragrafi 103-109.

- Në procesverbalin me nr. 987/1, datë 15.07.2022 të mbajtur nga komisioni “Për asgjësimin e aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimi” është propozuar kthimi i katër artikujve në magazinë në vlerën 246,282 lekë, ku nga institucioni nuk është prerë Fletë Hyrje dhe as asgjësimi i tyre, si dhe as kalimi në llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”.

- Për tre artikuj në vlerë totale 314,617 lekë, që komisioni ka vendosur të mos asgjësohen, por ti kalojnë për skrap Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, kjo vlerë është hequr nga kontabiliteti dhe nuk është reflektuar në formatin nr. 7/a “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” në llogarinë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën neto deri në momentin e transferimit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Paragrafi 103-109. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat për klasifikimin e zërave të aktiveve në llogaritë përkatëse kontabël dhe vlerësimin e vlerës së mbetur të këtyre aktiveve.

- Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa për sistemimin e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, duke mbajtur në këtë llogari në vlerën neto, ato aktive të cilat janë vlerësuar për jashtë përdorimi deri në momentin e asgjësimit apo të tjetërsimit të tyre.

*Afati: Në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i regjistrimit të aktiveve të regjistruara në kontabilitet u konstatua se një pjesë e këtyre aktiveve pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, vlera e tyre është papërfillshme ose zero. Këto aktive vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune dhe nga institucioni nuk janë marrë masa për të ngritur grupe pune me ekspertë të fushave, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve dhe rivlerësimin e tyre. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 103, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, pika 33. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues pranë Prokurorisë së Përgjithshme duhet të ngrëjë një komision me ekspertë të fushave, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, ku pas këtij shqyrtimi të bëhet rivlerësimi i vlerës së tyre. Mbi bazën e aktit të rivlerësimit, institucioni të realizojë regjistrimet e vlerës së tyre në kontabilitet.

*Afati: Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit rezultoi se në rubrikën D “*Fondet e konsoliduara nga Institucioni*” është pasqyruar llogaria 106 “*Teprica e Granteve kapitale të Huaja*” në vlerën 5,633,890 lekë.

Nga analiza e zërave në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto llogaria 106 është pasqyruar në vlerën zero lekë. Nga auditimi i hyrjeve të aktiveve pa pagesë rezultoi se vlera e paraqitur në llogarinë 106 “*Teprica e Granteve kapitale të Huaja*” ka të bëjë me kalimin në pronësi të aktiveve pa pagesë transferuar nga E.V., të cilat janë njohur në momentin fillestar në llogarinë 21 të aktiveve afatgjata dhe bërë hyrje në institucion me datën 05.01.2022.

Pasqyrimi i llogarisë 106 “*Teprica e Granteve kapitale të Huaja*” në vlerën 5,633,890 lekë në rubrikën D, është veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, paragrafi 1.1.2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa për sistemimin e llogarive në kontabilitet, duke debituar llogarinë 106 “*Teprica e granteve kapitale të huaja*” në vlerën 5,633,890 lekë dhe kredituar llogarinë 1011 “*Shtesa të fondit bazë*” për të njëjtën vlerë.

*Afati: Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrës së “*cash flow*” u konstatua se, nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2022 janë bërë shpenzime kapitale në shumën prej 104,904,075 lekë. Në pasqyrën 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” janë pasqyruar rritje nga blerjet e krijuara gjatë vitit 2022 në shumën prej 36,740,524 lekë, me një vlerë më pak prej 68,163,551 lekë, ku në shënimet shpjeguese është cituar se kjo vlerë është kaluar tek Prokuroria Rrethit Kukës, duke mos dokumentuar asnjë “*Gjurmë auditimi*” të kalimit të këtij transaksioni. Shuma e investimit për “*Rikonstruksionin e godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës*” është planifikuar dhe realizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për rrjedhim: Aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim dhe para se të bëhet miratimi i kalimit pa pagesë të vlerës së aktivitetit, detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “*Investime*”. Pas marrjes në dorëzim të punimeve, dhe administrimit të situacionit final, librezave të masave dhe relacionit teknik final, si dhe pas kolaudimit të ndërtesës, Prokuroria e Përgjithshme nxjerr një urdhër për kalim kapitali të vlerës 68,163,551 lekë tek Prokuroria e Rrethit Kukës.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar, paragrafi 2.1 “*Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2*”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## **7. Rekomandimi:**

**7.1.** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa në vijimësi, që për investimet të cilat janë planifikuar dhe realizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, para se të vihen në shfrytëzim dhe para se të bëhet miratimi i kalimit pa pagesë të vlerës së aktivitetit, detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që

grupohen në llogarinë 23 “Investime”, me qëllim dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi.

**7.2.** Aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim dhe para se të bëhet miratimi i kalimit pa pagesë të vlerës së aktivitetit, detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”. Pas marrjes në dorëzim të punimeve, dhe administrimit të situacionit final, librezave të masave dhe relacionit teknik final, si dhe pas kolaudimit të ndërtesës, Prokuroria e Përgjithshme nxjerr një urdhër për kalim kapitali të vlerës 68,163,551 lekë tek Prokuroria e Rrethit Kukës.

*Afati: Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se:

- Nga auditimi i pasqyrës së “Pozicionit financiar të konsoliduar” është bërë debitimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 1,724,750 lekë, vlerë e cila është kredituar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm”. Nga analiza e shpenzimeve buxhetore të vitit 2022 rezulton se, kjo shumë është detyrim ndaj palëve të treta për blerje mallra/ shërbime/ punë dhe jo të drejta të lindura ndaj institucionit, vlerë e cila duhet të ishte debituar në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

- Nga auditimin i të dhënave të pasqyrës 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” për pakësimet e aktiveve në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”, nga njësitë nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.

- Nga auditimi i të dhënave të pasqyrës “Cash Flow” dhe pasqyrimi i ndryshimit të llogarive në pasqyrën e pozicionit financiar rezultoi mosrakordim të shumave të arkëtuara për llogarinë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” dhe llogarinë 532 “Vlera të tjera”, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrës së “Pozicionit financiar”, por pa ndikim material.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, paragrafi 1.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës 1”; 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, si dhe “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 16-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike dhe Financës, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa në vijimësi, që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare të konsoliduara. Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korigjimin e sistemimit të tyre në pasqyrat financiare të viteve pasardhëse.

*Afati: Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratave “Për blerje set tavoline për sallën e mbledhjes me karrige”; “Për blerje karrige zyre copë 104” dhe “Për blerje fotokopje”, rezultoi se, magazinimi i mallrave me fletë-hyrje është bërë më përpara se komisioni të bëjë verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37 “Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i

çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë”.  
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 40-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandimi:** Nga ana e strukturave përgjegjëse të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme të merren masat në vazhdimësi, që mallrat shërbimet të merren në dorëzim nga OE, pas verifikimit fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë dhe se magazinimi i mallrave të bëhet pasi komisioni të kryejë verifikimin fizik të sasisë dhe cilësisë së mallrave të furnizuara.

*Afati: Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të zbatimit të kontratave për: Kontratë shërbimi/projektimi për Rikonstruksionin e godinës së Prokurorisë së Rrethit Kukës; Akt ekspertizë e godinës së Prokurorisë së Rrethit Kavajë; Akt ekspertizë e godinës së Prokurorisë së Rrethit Dibër; projekti “Shtesë godine të Prokurorisë së Rrethit Dibër”; Akt ekspertizë e godinës së Prokurorisë së Rrethit Korçë dhe realizimin e oponencës teknike, në lidhje me “Shtim kati në godinën e Prokurorisë së Rrethit Dibër” u konstatua se: Bashkëlidhur urdhër shpenzimit është vetëm kontrata e lidhur mes dy palëve dhe fatura tatimore e lëshuar nga OE, por mungon dokumentacioni vërtetues për realizimin e shërbimit si: Projektet e realizuara, akt ekspertiza dhe oponencat teknike. Mungesa e dokumentacionit bashkëlidhur dhe likuidimi i OE në mungesë të tyre janë veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 4, pika 26, “Dokument financiar”; neni 12, pika 3, nenin 4, pika 19 “Gjurma e auditimit”, si dhe të Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 40-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masat, që në të gjithë urdhër shpenzimet të ketë të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues të realizimit të shërbimit, me qëllim garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi.

*Afati: Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i likuidimit të dhjetë urdhër shpenzime për shërbime-dieta jashtë vendit të punonjësve, u konstatua se:

- Bashkëlidhur urdhër shpenzimit mungonte autorizimi për dërgim me shërbim jashtë vendit nga titullari i Prokurorisë së Përgjithshme. Bashkëlidhur janë vetëm urdhrat e NA drejtuar sektorit të financës dhe buxhetit për mbulimin e shpenzimeve ndaj delegacioneve.

- Mungonte ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve. Me anë të këtyre dokumenteve, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.

- Në urdhër shpenzimet mungon komisioni i marrjes në dorëzim të biletave, për të vërtetuar nëse shërbimi i blerë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në “Ftesën për ofertë”.

Sa më sipër veprimet në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22 të MFE, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 4 dhe me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 4, pika 26, nenin 4, pika 19 “Gjurma e auditimit”, si dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 40-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme të marrë

masa, që në të gjitha praktikat për udhëtime dieta për jashtë vendi, dokumentit të pagesave t'i bashkëngjitet, autorizimi për pjesëmarrje nga titullari i institucionit, ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve, si dhe procesverbali nga komisioni i marrjes në dorëzim të biletave, për të vërtetuar nëse shërbimi i blerë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në “Ftesën për ofertë”.

*Afati: Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të hartimit të Planit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025 dhe 2024- 2026 u konstatua se:

- Nuk ka takime të dokumentuara të veprimtarisë së GMS, për miratimin e Drejtuesit dhe anëtareve të Ekipeve të Menaxhimit të Programit dhe dokumentin e kërkesave buxhetore afatmesme.

- Në kërkesat e PBA 2024- 2026, në të dy fazat nuk janë paraqitur kërkesat e detajuara mbi investimet e planifikuara sipas kërkesave nga prokuroritë por janë përfshirë në Prokurorinë e Përgjithshme si një vlerë totale, vetëm duke përcaktuar emërtimin e projektit.

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2022 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025”; Udhëzimin nr. 5, datë 28.02.2023 të MFE “Për përgatitjen e Planifikimit Buxhetor Afatmesëm 2024- 2026”, si dhe neni 8, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Prokuroria e Përgjithshme të marrë masat në vijimësi, për dokumentimin me proces verbale, mbi takimet konsultative me përfaqësues të grupeve të interesit në lidhje me kërkesat buxhetore të PBA si dhe mbi mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Institucioni të marrë masat që planifikimin e investimeve ta paraqesë më të detajuar, duke specifikuar emërtimin e projektit se për cilën prokurori është planifikuar investimi.

*Afati: Në vijimësi*

## VI. ANEKSE

*Aneksi nr 1: Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.*

*Aneksi nr. 1/1: “Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”*

*000/lekë*

Art.	Emërtimi	Buxheti Vjetor		Fakti		%	
		Plani fillestar Viti 2022	Plani i rishikuar viti 2022	Buxheti viti 2022	Realizim i Vjetor	Realizimi t	
600	Paga	1,714,670	1,599,664	1,599,664	1,562,876		97.7%
601	Sigurime Shoqërore	200,000	192,113	192,113	186,634		97%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	379,450	338,560	338,560	335,120		99%
603	Subvencione						
604	Transferta Korente të Brendshme						
605	Transferta Korente të Huaja	150	150	150	138		92%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	12,530	12,530	12,336		98%
<b>Nën-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>2,294,270</b>	<b>2,143,017</b>	<b>2,143,017</b>	<b>2,097,104</b>		<b>98%</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara		2,985	2,985	2,984		100%
231	Kapitale të Trupëzuara	130,000	110,015	110,015	105,818		96%
232	Transferta Kapitale						

<b>Nën - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>130,000</b>	<b>113,000</b>	<b>113,000</b>	<b>108,802</b>	<b>96%</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara					
231	Kapitale të Trupëzuara					
232	Transferta Kapitale					
<b>Nën- Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>					
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>130,000</b>	<b>113,000</b>	<b>113,000</b>	<b>108,802</b>	<b>96%</b>
<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limitit</b>					<b>76</b>	
<b>Totali</b>		<b>2,424,270</b>	<b>2,256,017</b>	<b>2,256,017</b>	<b>2,205,982</b>	<b>97.77%</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, përpunoi Grupi i Auditimit

### Aneksi nr. 1/2: “Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2022”

Llog.		Plani fillestar	Ndryshimet	Plani perfundimtar
Llog. 600	AN nr. 3, date 12.03.2022 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 115/2021 per buxhetin e vitit 2022”	1,714,670,000	-42,867,000	1,671,803,000
	Shkresanr. 13930/1, date 05.08.2022		-24,000,000	1,647,803,000
	AN nr. 12, date 29.07.2022, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 115/2021 per buxhetin e vitit 2022”, te ndryshuar		-31,000,000	1,616,803,000
	Shkresa nr. 20981/1, date 22.11.2022		-9,500,000	1,607,303,000
	Shkresa nr. 2/64, date 30.12.2022		-7,639,031	<b>1,599,663,969</b>
Llog. 601	AN nr. 3, date 12.03.2022 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 115/2021 per buxhetin e vitit 2022”	200,000,000	-5,000,000	195,000,000
	Shkresa nr. 2/57, date 23.11.2022		-1,500,000	193,500,000
	Shkresa nr. 2/64, date 30.12.2023		-1,387,000	<b>192,113,000</b>
Llog. 602	AN nr. 3, date 12.03.2022 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 115/2021 per buxhetin e vitit 2022”	379,450,000	-75,890,000	303,560,000
	Shkresa nr. 13930/1, date 05.08.2022		24,000,000	327,560,000
	Shkresa nr. 20981/1, date 22.11.2022		11,000,000	<b>338,560,000</b>
Llog. 605	AN nr. 3, date 12.03.2022 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 115/2021 per buxhetin e vitit 2022”	150,000		<b>150,000</b>
Llog. 606	Shkresa nr. 2/64, date 30.12.2022	2,900,000	9,630,031	<b>12,530,031</b>
Llog. 230, 231	Akti Normativ nr. 17, date 01.12.2022 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 115/2021 per buxhetin e vitit 2022”, te ndryshuar	130,000,000	-17,000,000	<b>113,000,000</b>

### Aneksi nr. 1/3: “Projekte me financim të brendshëm për vitin 2022”

Investime- Viti 2022			
Emertimi i projektit te investimit	Plani fillestar 2022	Plani i rishikuar 2022	Realizimi 2022
	Vlera		
<b>Aparati i Prokurorise se Pergjithshme</b>			
Orendi zyre	4,000,000	5,900,000	5,394,864
Pajisje zyre	1,200,000	1,200,000	1,139,640
Te tjera pajisje teknike	1,200,000	1,200,000	775,979
Autovetura	15,000,000	13,246,000	13,200,000
Pajisje kompjuterike	18,600,000	16,250,000	16,230,041
"Impro" Software professional	10,000,000	0	0
Fond ingrire	77,830,000	0	0
Rikonstruksiongodine i Prokurorisë së Rrethit Kukës		65,347,224	65,179,423
Projekti godines së Prokurorisë së Rrethit Kukës		2,984,776	2,984,128
<b>Prokuroria e Rrethit Elbasan</b>			
Rikonstruksion godine	1,000,000	774,720	774,720
Pajisje zyre		225,280	165,600
<b>Prokuroria e Rrethit Fier</b>			
Sistemi i hyrje- daljes me karta	600,000		0

Prokuroria e Rrethit Vlore			
Orendi zyre	520,000	600,000	548,000
Prokuroria e Rrethit Tropoje			
Pajisje zyre	50,000	50,000	50,000
Prokuroria e Rrethit Tirane			
Pajisje zyre		224,397	210,000
Vendosja e sistemit me kamera		2,723,603	
Prokuroria e Rrethit Berat			
Rikonstruksion godine		1,074,000	1,058,212
Vendosja e sistemit me kamera		550,000	491,856
Orendi zyre		650,000	599,999
	130,000,000	113,000,000	108,802,462

*Aneksi nr. 1/4: 'Shpenzimet buxhetor sipas klasifikimit ekonomik për vitin 2023'.*

000 Lekë

Art.	Emertimi	Buxheti Vjetor	
		Plani fillestar Viti 2023	Plani i rishikuar viti 2023
600	Paga	1,831,670	2,741,484
601	Sigurime shoqerore	223,500	248,057
602	Mallra dhe sherbime te tjera	355,180	365,762
603	Subvencione		
604	Transferta Korente te Brendshme		
605	Transferta Korente te Huaja	150	150
606	Trans. Per Buxh. Fam. dhe Ind.	0	5,919
Nen- Totali	Shpenzime Korrente	2,410,500	3,361,372
230	Kapitale te Patrupezuara	60,000	
231	Kapitale te Trupezuara	150,000	
232	Transferta Kapitale		
Nen- Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	210,000	144,400
230	Kapitale te Patrupezuara		
231	Kapitale te Trupezuara		
232	Transferta Kapitale		
Nen- Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	210,000	144,400
Shpenzime nga Te ardhurat jashte limitit			0
Totali		2,620,500	3,505,772

*Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, përpunoi Grupi i Auditimit*

*Aneksi nr. 1/5: "Ndryshimet buxhetore përgjatë vitit 2023"*

Llog.		Planifillestar	Ndryshimet	Planiperfundimtar
Llog. 600	Shkresa e MFE nr. 11515/1, date 30.06.2023	1,831,670,000	89,530,055	1,921,200,055
	VKM nr. 437.			
	Nr. 1236/2, date 03.08.2023		378,778,000	2,299,978,055
	Shkresa nr. 95/82		40,000,000	2,339,978,055
	VKM nr. 755, date 20.12.2023		400,000,000	2,739,978,055
Llog. 600	VKM nr. 795, date 28.12.2023		1,505,886	<b>2,741,483,941</b>
Llog. 601	Shkresa e MFE nr. 11515/1, date 30.06.2023	223,500,000	10,469,945	233,969,945
	VKM nr. 437.			
	Nr. 1236/2, date 03.08.2023		21,222,000	255,191,945
	Akti normativnr. 6, date 14.12.2023		-7,135,000	<b>248,056,945</b>
Llog. 602	Kaluar te llog. 606, nr. 95/44	355,180,000	-1,552,828	353,627,172
	AN nr. 5, date 18.10.2023		45,000,000	398,627,172
	Shkresanr. 95/82		-40,000,000	358,627,172
	Akti normativnr. 6, date 14.12.2023		7,135,000	<b>365,762,172</b>
Llog. 606	Shkresa nr. 95/45	2,900,000	1,552,828	4,452,828

	Shkresa nr. 95/59		149,134	4,601,962
	Shkresa nr. 95/76		495,343	5,097,305
	Shkresa nr. 95/85		821,559	<b>5,918,864</b>
Llog. 230- 231	Akti normative nr. 6, date 14.12.2023	210,000,000	-65,600,000	<b>144,400,000</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, përpunoi Grupi i Auditimit

**Aneksi nr. 1/6: “Projekte me financim të brendshëm për vitin 2023”**

<b>Investime- Viti 2023</b>			
<b>Institucioni</b>	<b>Emertimi i projektit te investimit</b>	<b>Plani fillestar 2023</b>	<b>Plani i rishikuar 2023</b>
		<b>Vlera</b>	
<b>Aparati i Prokurorise se Pergjithshme</b>			
Prokuroria e Pergjithshme (Diber+ Korce)	Projekt (Studime, projekte)	60,000,000	1,690,000
Aparati i Prokurorise se Pergjithshme	Pajisje zyre	1,200,000	1,200,000
Aparati i Prokurorise se Pergjithshme	Autovetura	10,000,000	23,625,000
Aparati i Prokurorise se Pergjithshme	Pajisje kompjuterike	36,800,000	22,140,000
Aparati i Prokurorise se Pergjithshme	Software Camsi	50,000,000	
Prokurorise e Pergjithshme	Orendi zyre	3,000,000	
Prokuroria e Pergjithshme	Rikonstruksion	42,000,000	
Prokuroria e Pergjithshme	Sistemi i hyrje-daljes me karta 14 prok.		
Prokuroria e Pergjithshme (Rikonst. per Prok. Diber)	Rikonstruksion i pjesshem godine		58,406,215
Prokurorise e Apelit Tirane	Sistem kondicionimi	7,000,000	
Aparati i Prokurorise se Pergjithshme	TVSH+ Takse doganore		910,000
<b>Prokuroria e Rrethit Tirane</b>			
Prokuroria e Rrethit Tirane	Pajisje zyre		1,000,000
Prokuroria e Rrethit Tirane	Motocikleta		120,000
Prokuroria e Rrethit Tirane	Blerje e instalim kondicioneresh		500,000
Prokuroria e Rrethit Tirane	Rikonstruksion i godines dhe i rrjetit elektrik		18,238,785
Prokuroria e Rrethit Tirane	Sistem kondicionimi		
Prokuroria e Rrethit Tirane	Rikonstruksion		90,000
<b>Prokuroria e Rrethit Berat</b>			
Prokuroria e Rrethit Berat	Blerje e instalim kondicioneresh		750,000
Prokuroria e Rrethit Berat	Rikonstruksion		300,000
<b>Prokuroria e Rrethit Diber</b>			
Prokuroria e Rrethit Diber	Pajisje zyre		400,000
<b>Prokuroria e Rrethit Durres</b>			
Prokuroria e Rrethit Durres	Blerje e instalim kondicioneresh		550,000
Prokuroria e Rrethit Durres	Orendi zyre		250,000
Prokuroria e Rrethit Durres	Orendi zyre		350,000
<b>Prokuroria e Rrethit Elbasan</b>			
Prokuroria e Rrethit Elbasan	Sistem kondicionimi		11,100,000
<b>Prokuroria e Rrethit Fier</b>			
Prokuroria e Rrethit Fier	Pajisje zyre (Rafta arshive)		260,000
<b>Prokuroria e Rrethit Gjirokaster</b>			
Prokuroria e Rrethit Gjirokaster	Rikonstruksion		120,000
Prokuroria e Rrethit Gjirokaster	Pajisje zyre		460,000
<b>Prokuroria e Rrethit Korce</b>			



Prokuroria e Rrethit Korce	Rikonstrukcion		120,000
<b>Prokuroria e Rrethit Kukes</b>			
Prokuroria e Rrethit Kukes	Orendi zyre		1,200,000
<b>Prokuroria e Rrethit Lezhe</b>			
Prokuroria e Rrethit Lezhe	Pajisje zyre		500,000
<b>Prokuroria e Rrethit Vlore</b>			
Prokuroria e Rrethit Vlore	Rikonstrukcion godine		
Prokuroria e Rrethit Vlore	Orendi zyre		120,000
Tot.			210,000,000
			144,400,000

**Aneksi nr 2: “Mbi auditimin e llogarive vjetore”.**

**Aneksi nr. 2/1: “Aktivet qarkulluese”.**

*Në lekë*

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
2		I. Aktivet Afat shkurtra	691,208,985	994,451,445
3		1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	637,898,907	939,013,232
4	531	Mjete monetare në Arkë		
5	512	Mjete monetare ne Banke	615,283,276	919,604,651
6	520	Disponibilitete në Thesar	22,615,631	19,408,581
8	532	Vlera te tjera (pulla)		
11		2. Gjendje Inventari qarkullues	24,731,277	27,980,654
12	31	Materiale	23,307,705	26,487,742
13	32	Inventar i Imet	1,423,572	1,492,912
16	35	Mallra		
21		3. Llogari te Arkëtushme	23,543,837	23,271,006
22	411	Klientë e llogari të ngjashme	700	0
23	423-429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	140,937	0
24	431	Tatim e Taksa		
29	437-439	Organizma te tjere shteterore		
32	468	Debitorë të ndryshëm	3,803,861	3,803,861
33	4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	19,598,339	19,467,145
36		4. Të tjera aktive afatshkurtra	5,034,964	4,186,553
37	409	Parapagime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	5,034,964	4,186,553

Burimi: PP, përpunuar nga grupi i auditimit

**Aneksi nr. 2/2: “Aktivet afatgjata”.**

*Në lekë*

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
<b>42</b>		<b>II. Aktivet Afat gjata</b>	<b>579,448,998</b>	<b>654,043,864</b>
43	20	<b>1. Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>379,850</b>	<b>636,200</b>
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	120,000	192,000
45	202	Studime dhe kërkime	188,750	302,000
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	71,100	142,200
47	21	<b>2. Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>579,069,148</b>	<b>653,407,664</b>
48	210	Toka, Troje, Terrene	161,355,109	161,355,109
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	151,494,022	159,467,392
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	60,628,134	75,785,167
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	113,643,907	197,992,133
53	215	Mjete Transporti	16,114,203	7,652,977
54	216	Rezerva Shtetërore		
56	218	Inventar ekonomik	75,833,773	51,154,886
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
62		<b>4. Investime</b>		
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		
Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
42		II. Aktivet Afat gjata	579,448,998	654,043,864

43	20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	379,850	636,200
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	120,000	192,000
45	202	Studime dhe kërkime	188,750	302,000
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	71,100	142,200
47	21	2. Aktive Afatgjata materiale	579,069,148	653,407,664
48	210	Toka, Troje, Terrene	161,355,109	161,355,109
50	212	Ndërtesa e Konstruksione	151,494,022	159,467,392
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	60,628,134	75,785,167
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	113,643,907	197,992,133
53	215	Mjete Transporti	16,114,203	7,652,977
54	216	Rezerva Shtetërore		
56	218	Inventar ekonomik	75,833,773	51,154,886
57	24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
62		4. Investime		
63	230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		

Burimi: PP, përpunuar nga grupi i auditimi

**Aneksi nr. 2/3: “Dalje e Aktiveve AGJ nga llogaria 218 për vitin 2022”.**

Artikulli	FD PP	Subjekti përfitues	FH	vlera
Printer cop 2	nr. 17, datë 28.07.2022	Prokuroria e Rrethit Tiranë	34, datë 23.07.2022	93,888
Sëitch	nr. 18, datë 06.09.2022	Prokuroria e Rrethit Kukës	nr.11 datë 06.09.2022	523,624
Kompjuter	nr.18, datë 06.09.2022	Prokuroria e Rrethit Kukës	nr.11 datë 06.09.2022	240,480
Desktop Kompjuter HP	nr.19, datë 06.09.2022	Prokuroria e Rrethit Dibër	nr.1 datë 07.09.2022	185,220
Desktop Kompjuter	nr.20 datë 06.09.2022	Prokuroria e Rrethit Kurbin	nr.21 datë 06.09.2022	196,668
Kompjuter	nr.21, datë 09.09.2022	Prokuroria e Rrethit Vlore	nr.1 datë 12.09.2022	68,160
Pajisje zyre	nr.22, datë 13.09.2022	Prokuroria e Rrethit Dibër	nr.1 datë 07.09.2022	247,824
Kabinet Metalik	nr.23, datë 23.09.2022	Prokuroria e Rrethit Tiranë	nr.44 datë 23.09.2022	99,208
Dollap/kabinet metalik	nr.24, datë 26.09.2022	Prokuroria e Rrethit Tiranë	nr.45 datë 26.09.2022	59,802
Kolltuk	nr. 26, datë 04.10.2022	Prokuroria e Rrethit Kukës	nr.15 datë 01.11.2022	76,480
Desktop Kompjuter	nr. 27, datë 05.10.2022	Prokuroria e Rrethit Gjirokastër	nr.28 datë 06.12.2022	113,400
UPS 1000 VA	nr.29, datë 08.11.2022	Prokuroria e Rrethit Elbasan	nr.28 datë 06.12.2022	7,440
HP290G2PC	nr.29, datë 08.11.2022	Prokuroria e Rrethit Krujë	nr.29 datë 08.11.2022	68,160
Telefon	nr.3, datë 04.05.2022	Prokuroria e Rrethit Tirane	20, datë 04.05.2022	58,858
Telefon	nr.4, datë 22.06.2022	Prokuroria e Rrethit Durrës	nr.2 datë 22.06.2022	158,078
Printer	nr.6, datë 14.07.2022	Prokuroria e Rrethit Berat	nr.14 datë 14.07.2022	19,560
Kompjuter	nr.8, datë 15.09.2022	Prokuroria e Rrethit Vlorë	nr.26 datë 16.09.2022	177,660
Kompiturer, Microtoner	nr.9, datë 16.09.2022	Prokuroria e Rrethit Sarandë	nr.15 datë 20.09.2022	332,256
HP Note book, elite book	nr.10, datë 22.09.2022	Prokuroria e Rrethit Tiranë	nr.43 datë 22.09.2022	89,839
Telefon IP	nr.12 datë 13.10.2022	Prokuroria e Rrethit Kukës	nr.12 datë 13.10.2022	158,077
Kompjuter	nr.14 datë 09.11.2022	Prokuroria e Rrethit Tropojë	nr.24 datë 16.11.2022	86,448
Kompituter,Mickrocover	nr.15 datë 09.11.2022	Prokuroria e Rrethit Berat	nr.25 datë 18.11.2022	192,456
Printer	nr.17 datë 09.11.2023	Prokuroria e Rrethit Sarandë	nr.17 datë 09.11.2023	19,560
Fotokopje	nr.21 datë 07.12.2022	Prokuroria e Rrethit Korçë	nr.30 datë 12.12.2022	474,000
Printer	nr.22 datë 23.12.2022	Prokuroria e Rrethit Elbasan	nr.4 datë 23.12.2022	39,120
				3,786,266

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimi

**Aneksi nr. 2/4: “Fletë hyrjeve për aktivet e blera gjatë vitit 2022”**

Artikulli	FH	Subjekti Blerës	Vlera
Lap Top cop 1	nr.1/1, datë 17.11.2022	B. T.	192,000
Fotokopje MFP/Xerox Atlantik	nr.2, datë 22.11.2022	K. sh.p.k	1,422,000
PC Deskop/lenova	nr.3, datë 23.11.2022	A. sh.p.k	4,464,000
Switch, Software, System për Autentifikim	nr.9 datë 21.12.2022	S.T.A. sh.p.k	10,152,040
		Totali	16,230,040

Artikulli	FH	Subjekti Blerës	Vlera
Moket/Tapet	nr. 6, datë 21.04.2022	A.	709,979
Rafte metalike	nr, 8 datë 17.06.2022	F. shpk	502,800

Fshesë	nr. 10 datë 15.07.2022	E.	66,000
Rafte metalike	nr. 13 datë 15.11.2022	F. SHPK	498,240
Tvolina/karrike	nr. 14 datë 22.02.2022	T. L.	1,254,000
Karige	nr. 15 datë 22.12.2022	B. A.	4,140,864
Rafte metalike	nr. 16 datë 27.12.2022	F. SHPK	138,600
		<b>Totali</b>	<b>7,310,483</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimi

**Aneksi nr. 2/5: “Pasivet Afatshkurtra”.**

*Në lekë*

Nr.	Ref. Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021
<b>66</b>		<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>659,174,820</b>	<b>959,167,903</b>
<b>67</b>		<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>657,697,708</b>	<b>957,690,791</b>
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	467,436	2,383,132
69	42	Detyrime ndaj personelit	11,625,705	11,451,123
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,636,884	1,746,473
75	435	Sigurime Shoqërore	3,438,638	3,374,314
76	436	Sigurime Shëndetësorë	515,918	512,103
77	437	Organizma te tjerë shtetërore		
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	629,118,907	930,233,232
82	467	Kreditore te ndryshëm	6,948,722	4,186,553
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime	3,945,498	3,803,861
84	49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
<b>85</b>		<b>2. Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>1,477,112</b>	<b>1,477,112</b>
88	478	Diferenca konvertimi pasive	1,477,112	1,477,112

Burimi: PP, përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT